

LIGJ
Nr.9267, datë 29.7.2004

**PËR VEPRIMTARINË E SIGURIMIT, TË RISIGURIMIT DHE NDËRMJETËSIMIT NË
SIGURIME DHE RISIGURIME, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR 9338, DATE 16.12.2004
DHE LIGJIN 9685, DATE 26.02.2007.**

Në mbështetje të neneve 78, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është vendosja e parimeve dhe e rregullave të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe mbikëqyrjen nga shteti të subjekteve që marrin përsipër të ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për shoqëritë vendase të sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe degëve të shoqërive të huaja, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të operacioneve që lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Sigurim” nënkupton transferimin e një rreziku të mundshëm, të një humbjeje financiare ose të një dëmi material nga i siguruari te siguruasi, sipas një kontrate sigurimi.
2. “Sigurim i detyruar” nënkupton sigurimin, për të cilin ekziston një detyrim ligjor.
3. “Sigurim vullnetar” nënkupton sigurimin, për të cilin nuk ekziston një detyrim ligjor.
4. “Risigurim” nënkupton transferimin e një pjese të rrezikut nga shoqëria e sigurimit te shoqëria e risigurimit, sipas një marrëveshjeje risigurimi.
5. “Bashkësigurim” nënkupton veprimtarinë, nëpërmjet së cilës dy ose më shumë sigurues marrin përsipër së bashku një rrezik, sipas përqindjeve të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur midis tyre.
6. “Rrezik” nënkupton humbjen e mundshme në lidhje me një ngjarje të pritshme në të

ardhmen, e cila shkakton dëm.

7. “Shoqëri sigurimi” nënkupton një person juridik me seli qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, i licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimi nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, në përputhje me këtë ligj.

8. “Shoqëri risigurimi” nënkupton një person juridik me seli qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, i licencuar për të ushtruar veprimtari risigurimi nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, në përputhje me këtë ligj.

9. “Licencë” nënkupton aktin administrativ të dhënë me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, që i njuh të drejtën një personi fizik apo juridik të krijojë, të ushtrojë dhe të zgjerojë veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit.

10. “I siguruar” nënkupton personin, i cili ka nënshkruar një kontratë sigurimi me një shoqëri sigurimi.

11. “Sigurues” nënkupton shoqërinë e sigurimit, e licencuar sipas dispozitave të këtij ligji.

12. “Risigurues” nënkupton shoqërinë e risigurimit, e licencuar sipas dispozitave të këtij ligji.

13. “Përfitues” nënkupton personin që gëzon të drejtën e dëmshpërblimit që rrjedh nga kontrata e sigurimit.

14. “Veprimtari sigurimi” nënkupton nënshkrimin dhe zbatimin e kontratave të sigurimit, të lidhura midis shoqërisë së sigurimit dhe të të siguruarit.

15. “Veprimtari risigurimi” nënkupton nënshkrimin dhe zbatimin e kontratave të risigurimit, të lidhura midis shoqërisë së sigurimit dhe shoqërisë së risigurimit, për të siguruar atë pjesë të rrezikut që tejkalon mbulimin maksimal të përgjegjësive të shoqërisë së sigurimit.

16. “Aktuar” nënkupton një matematicien, i kualifikuar edhe në statistikë dhe kontabilitet, i autorizuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, i cili është përgjegjës për llogaritjen e primeve, provigjoneve teknike, dividendëve dhe tabelave të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë.

17. “Operacione që rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit dhe e risigurimit” nënkupton vlerësimin e rrezikut, vlerësimin e dëmeve, shërbime aktuariale ndërmjetësimi në shitjen e pjesës së mbetur të pasurisë së dëmtuar, konsulencën në sigurime dhe risigurime, shërbime intelektuale dhe teknike të lidhura me veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit.

18. “Marrëveshje risigurimi” nënkupton një marrëveshje të përfunduar midis shoqërisë së sigurimit dhe të risigurimit, që përcakton termat dhe kushtet për rreziqet që do të risigurohen.

19. “Ngjarje e siguruar” nënkupton ngjarjen e parashikuar në kontratën e sigurimit, e cila, kur ndodh, i jep të drejtën të siguruarit të dëmshpërblehet nga siguruesi.

20. “Kontrata e sigurimit” nënkupton marrëveshjen me shkrim midis palëve, nëpërmjet së cilës siguruesi merr përsipër kundrejt pagesës së primit, për t’i ofruar të siguruarit një dëmshpërblim me vërtetimin e ngjarjes së sigurimit.

21. “Prim” nënkupton shumën e paguar menjëherë ose në mënyrë periodike nga i siguruari siguruesit ose nga një person që vepron në emër të tij, me qëllim sigurimin ndaj një rreziku të përcaktuar në kontratën e sigurimit ose të risigurimit.

22. “Prim bruto i shkruar” nënkupton primin e regjistruar në llogaritë e shoqërisë së sigurimit, sipas një kontrate sigurimi përpara zbritjes së komisioneve, shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe primeve të ceduara në risigurim.

23. “Prim neto i shkruar” nënkupton primin bruto të marrë, sipas një kontrate sigurimi, pasi zbritet pjesa e primit e ceduar në risigurim.

24. “Prim i fituar” nënkupton pjesën e primit të shkruar, sipas kontratës së sigurimit ose të risigurimit, e cila i përket vitit aktual financiar, pavarësisht nga arkëtimi i tij.

25. “Prim i pafituar” nënkupton pjesën e primit të shkruar, sipas kontratës së sigurimit ose të risigurimit, e cila i përket vitit të ardhshëm financiar, pavarësisht nga arkëtimi i tij.

26. “Kuota të fituara” nënkupton pjesën e primit të arkëtuar në vitin financiar nga

shoqëria e sigurimit të jetës.

27. “Cedim” nënkupton kalimin e një pjese të rrezikut të siguruar nga një shoqëri sigurimi në një shoqëri risigurimi.

28. “Dëm” nënkupton humbjen financiare ose jofinanciare të shkaktuar nga ndodhja e rrezikut të siguruar.

29. “Dëmshpërblim” nënkupton shumën e paguar për një humbje financiare ose jofinanciare, sipas një kontrate sigurimi, me ndodhjen e ngjarjes së siguruar.

30. “Vlerësues dëmi” nënkupton personin fizik ose juridik, i licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, i cili merret me vlerësimin e dëmeve të ndodhura.

31. “Provigjon” nënkupton një shumë të llogaritur për mbulimin e përgjegjësive.

32. “Provigjon teknik” nënkupton një shumë të llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila i shërben siguruesit për të mbuluar përgjegjësitë që lindin nga kontratat e sigurimit.

33. “Provigjon matematik” nënkupton një shumë të llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila i shërben siguruesit për të mbuluar përgjegjësitë që lindin vetëm nga kontrata e sigurimit të jetës.

34. “Aftësi paguese” nënkupton aktivet e shoqërisë së siguruesit, të lira nga çdo detyrim ose përgjegjësi, pas zbritjes së elementeve të patrupëzuara, e cila shërben për të garantuar në vazhdimësi plotësimin e detyrimeve të përgjegjësive të kontraktuara gjatë veprimtarisë së sigurimit, nga burimet e veta.

35. “Fond garancie” nënkupton një shumë në mjete monetare e depozituar nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit në një llogari bankare qëllimore me të njëjtin emër, në njërën nga bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku shoqëria ka selinë qendrore të saj, e detyrueshme për t’u disponuar nga siguruesi që nga çasti i fillimit të veprimtarisë dhe në vazhdim.

36. “Portofol sigurimi” nënkupton tërësinë e kontratave të sigurimit të një klase ose të disa klasave të sigurimeve të përfunduara nga një sigurues.

37. “Menaxhim i rrezikut” nënkupton tërësinë e metodave dhe të rregullave që përdoren nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit për përcaktimin, vlerësimin dhe analizimin e të gjitha rreziqeve të mundshme, me qëllim shmangien e humbjeve financiare.

38. “Veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime” nënkupton ofrimin, negocimin, nënshkrimin dhe shitjen e kontratave të sigurimit ose risigurimit, e cila ushtrohet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve.

39. “Agjent” nënkupton një person juridik, i licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve dhe i autorizuar nga shoqëria e sigurimit për të kryer veprimtari ndërmjetësimi në sigurime në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit.

40. “Shoqëri agjentësh” nënkupton një person juridik të licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve dhe i autorizuar nga shoqëria e sigurimit për të kryer veprimtari ndërmjetësimi në sigurime, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit.

41. “Broker” nënkupton një person fizik, i autorizuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve dhe që ushtron veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime në emër të shoqërisë së brokerimit.

42. “Shoqëri brokerimi” nënkupton një person juridik, të licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve dhe i autorizuar nga i siguruari për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime në emër të tij.

43. “Garanci financiare” nënkupton një shumë mjeteve monetare të bllokuara, e cila depozitohet në banka në territorin e Republikës së Shqipërisë nga brokeri në çastin e krijimit, për llogari të Autoritetit dhe ruhet gjatë gjithë veprimtarisë së tij.

44. “Sigurim i përgjegjësive profesionale” nënkupton sigurimin kundrejt përgjegjësive ligjore ndaj palëve të treta për humbje ose dëmtime të shkaktuara nga neglizhenca, gabime ose

moskryerje të veprimeve profesionale të vetë personit ose të të punësuarit prej tij.

45. “Drejtori” nënkupton organin më të lartë drejtues të një shoqërie sigurimi ose risigurimi, i zgjedhur me votim nga këshilli mbikëqyrës.

46. “Drejtor” nënkupton çdo person fizik që në aktin e emërimit cilësohet si i tillë.

47. “Degë” nënkupton njësinë organizative që krijohet e veçuar nga selia qendrore e shoqërisë, e cila vepron si pjesë e saj brenda funksioneve të përcaktuara nga shoqëria mëmë dhe që ushtron të njëjtën veprimtari në emër dhe për llogari të shoqërisë mëmë.

48. “Zyrë përfaqësimi” nënkupton njësinë organizative të shoqërisë së huaj të sigurimit ose të risigurimit, që nuk ushtron veprimtari sigurimi ose risigurimi dhe promovon interesat e shoqërisë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sa herë që në këtë ligj do të përdoret termi “shoqëri sigurimi”, do të nënkuptohet shoqëri sigurimi dhe risigurimi.

Sa herë që në këtë ligj do të përdoret termi “veprimtari sigurimi”, do të nënkuptohet veprimtari sigurimi dhe risigurimi.

Sa herë që në këtë ligj do të përdoret termi “ndërmjetësim”, do të nënkuptohet ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime.

Sa herë që në këtë ligj do të përdoret termi “Autoriteti”, do të nënkuptohet Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, rregullat për organizimin dhe funksionimin e të cilit rregullohen me ligj të veçantë.

Në këtë ligj fjalët në njëjës mund të interpretohen edhe në shumës dhe e kundërta, kurdoherë që ndryshimi është i domosdoshëm për interpretimin e dispozitës.

Neni 4

Kufizimi i objektit të veprimitarisë së shoqërisë të sigurimit

Shoqëria e sigurimit, dega e shoqërisë së huaj e kufizojnë objektin e veprimitarisë vetëm në veprimtari sigurimi, risigurimi dhe operacionet që rrjedhin drejtpërdrejt nga këto veprimtari, duke përfshirë çdo veprimtari tjetër tregtare.

Neni 5

Sigurimi i drejtpërdrejtë për rreziqet që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë

1. Nuk lejohet sigurimi i drejtpërdrejtë pranë një shoqërie të huaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një rrezik që i përket një personi, një sendi ose një përgjegjësie, që gjendet në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

2. Dispozita e pikës 1 të këtij neni nuk zbatohet për sigurimin e rreziqeve të lidhura me transportin detar dhe ajror.

3. Autoriteti, në shmangie të dispozitës së pikës 1 të këtij neni, mund të autorizojë sigurime të drejtpërdrejta pranë një shoqërie të huaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në ato raste kur rreziku nuk mbulohet nga shoqëria vendase ose dega e shoqërisë së huaj, që ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Risigurimet - Përgjegjësia e siguresit

1. Shoqëria e sigurimit mund të risigurojë pjesë të përgjegjësive që ka kontraktuar me të siguarit te shoqëritë risiguruese vendase dhe degët e shoqërive të huaja risiguruese të licencuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Pavarësisht sa është parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, shoqëria e sigurimit mund të

risigurojë pjesë të përgjegjësive që ka kontraktuar me të siguruarin me shoqëritë e huaja risiguruese të miratuara nga Autoriteti *që nuk kanë degë në Republikën e Shqipërisë.

3. Shoqëritë e sigurimit vendase, të licencuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe/ose risigurimi, mund të ushtrojnë veprimtari risigurimi vetëm me miratimin e Autoritetit.

4. Shoqëria e sigurimit është përgjegjëse e vetme ndaj të siguruarve, nënshkrues apo përfitues të kontratave të sigurimit, pavarësisht se për mbulimin e përgjegjësive që ka marrë përsipër është risiguruar.

Neni 7

Klasat e sigurimeve

Veprimtaria e sigurimit ushtrohet në përputhje me klasat e mëposhtme:

A. Në përputhje me rreziqet, klasat e sigurimeve janë:

1. Sigurimi i aksidenteve (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale) mbulon:

1.1 pagesën e menjëherëshme në mjete monetare të shumës totale, të rënë dakord për kompensimin e dëmit;

1.2 pagesën me këste në mjete monetare të shumës totale, të rënë dakord për kompensimin e dëmit;

1.3 kombinimin e 1.1 dhe 1.2;

1.4 pagesën ndaj plagosjeve, çrregullimeve shëndetësore ose vdekjes së pasagjerëve.

2. Sigurimi i sëmundjeve mbulon:

2.1 të ardhura fikse financiare nga paaftësia shëndetësore;

2.2 rimbursimin e shpenzimeve të trajtimit spitalor;

2.3 kombinimin e 2.1 dhe 2.2.

3. Sigurimi i mjeteve tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina) mbulon dëmtimet ose humbjet nga:

3.1 mjetet tokësore motorike;

3.2 mjetet tokësore jomotorike.

4. Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina mbulon dëmtimet ose humbjet nga mjetet lëvizëse mbi shina.

5. Sigurimi i avionëve mbulon dëmtimet ose humbjet e pësuar nga mjetet ajrore.

6. Sigurimi i anijeve mbulon dëmtimet ose humbjet e pësuar nga:

6.1 anijet lumore dhe të kanaleve;

6.2 anijet e liqeneve;

6.3 anijet detare.

7. Sigurimi i mallrave në transport (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve) mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet e mallrave gjatë transportit ose bagazhet, pavarësisht nga mënyra e transportit.

8. Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës mbulon dëmtimin ose humbjen e sendeve (të ndryshme nga ato të përfshira në pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7), të shkaktuara nga:

8.1 zjarret;

8.2 shpërthimet;

8.3 stuhitë;

8.4 forcat e natyrës;

8.5 energjia nukleare;

8.6 shkarja e tokës.

9. Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet në pasuri (të ndryshme nga ato që përfshihen në pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7) kur dëmi është shkaktuar nga breshëri ose nga ngrica dhe çdo ngjarje e tillë, si vjedhja, të ndryshme nga ato të përmendura në

pikën 8.

10. Sigurimi i përgjegjësive civile nga përdorimi i automjeteve mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i automjeteve mbi tokë (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

11. Sigurimi i përgjegjësive civile nga përdorimi i avionëve mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i avionëve (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

12. Sigurimi i përgjegjësive civile për anijet (detare, të liqeneve dhe të lumenjve, si dhe ato të kanaleve) mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i anijeve ose barkave (anije të vogla), që lundrojnë në det, liqene, lumenj dhe kanale lundrimi (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

13. Sigurimi i përgjegjësive civile të përgjithshme mbulon të gjitha përgjegjësitë, përveç atyre të përmendura në pikat 10, 11 dhe 12.

14. Sigurimi i kreditit mbulon:

14.1 rrezikun e mospagesës për shkak të paaftësisë pagueuse ose rrethanave të tjera;

14.2 kreditë e eksportit dhe rreziqe të tjera që shoqërohen me eksportin, tregtinë dhe investimet brenda dhe jashtë vendit;

14.3 kreditë e shlyera me këste;

14.4 kreditë hipotekore dhe huatë Lombard;

14.5 kreditë bujqësore;

14.6 kredi të tjera.

15. Sigurimi i garancive mbulon:

15.1 garancitë e drejtpërdrejta;

15.2 garancitë e tërthorta.

16. Sigurimi i humbjeve të ndryshme financiare mbulon humbjet financiare të shkaktuara si pasojë e:

16.1 rrezikut në punësim;

16.2 pamjaftueshmërisë së të ardhurave (e përgjithshme);

16.3 motit të keq;

16.4 humbjes së të ardhurave;

16.5 shpenzimeve të përgjithshme të paparashikuara;

16.6 shpenzimeve tregtare të paparashikuara;

16.7 humbjes së vlerës në treg;

16.8 humbjes nga qiratë ose të ardhurat;

16.9 humbjes indirekte nga tregtimi, të ndryshme nga ato të përmendura më sipër;

16.10 humbjeve financiare (të tjera nga ato tregtare);

16.11 llojeve të tjera të humbjeve financiare.

17. Sigurimi i mbrojtjes ligjore mbulon:

17.1 shpenzimet për shërbimet ligjore dhe ato gjyqësore.

18. Sigurimi i asistencës (ndihmës) mbulon:

18.1 ndihmën për personat që kanë vështirësi gjatë udhëtimeve ose në raste të tjera të largësisë nga shtëpia ose vendbanimi i përhershëm.

19. Sigurim jete - vdekje mbulon:

19.1 sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar, sigurimin për vdekjen, sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme, sigurimin e jetës me kthim të primeve.

20. Sigurim martese - lindje mbulon:

20.1 shpenzimet që shoqërojnë martesën ose lindjen e fëmijëve.

21. Sigurim jete i lidhur me fonde të investimeve mbulon:

21.1 sigurimin e jetës, të lidhur me aksione në fondet e investimeve, ku i siguruari merr përsipër rrezikun e investimit në lidhje me vlerën e aksioneve ose letrave të tjera me vlerë.

22. Sigurimi i administrimit të fondeve kolektive mbulon:

22.1 sigurimin e individëve të bashkuar për qëllime të kapitalizimit të kontributeve të tyre dhe shpërdarjes së aktiveve në raport me fondet e akumuluar midis personave që kanë arritur një moshë të caktuar (të mbijetuarve) ose midis përfituesve të sigurimit, në rast vdekjeje të personave të siguruar.

23. Sigurimi i fondeve për pagesa, i cili mbulon sigurimin e jetës së bazuar në llogaritjet aktuariale, sipas së cilës, në këmbim të një pagese të vetme ose periodike, të rënë dakord paraprakisht, i siguruari dëmshpërblehet për periudhën e caktuar dhe shumën përkatëse.

B. Klasifikimi në grupe sigurimi.

Veprimtaria e sigurimit që mbulon më shumë se një klasë sigurimi do të klasifikohet në grupe sigurimi si më poshtë:

1. Klasat nr. 1 dhe 2 do të emërtohen “Sigurim i aksidenteve dhe e shëndetit”.

2. Klasat nr.1 (paragrafi i katërt), 3, 7 dhe 10 do të emërtohen “Sigurime motorike”.

3. Klasat nr.1 (paragrafi i katërt) 4, 6, 7 dhe 12 do të emërtohen “Sigurimi i marinës dhe i transportit”.

4. Klasat nr.1 (paragrafi i katërt) 5, 7 dhe 11 do të emërtohen “Sigurimi i avionëve”.

5. Klasat nr.8 dhe 9 do të emërtohen “Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë”.

6. Klasat nr.10, 11, 12 dhe 13 do të emërtohen “Sigurimi i përgjegjësive”.

7. Klasat nr.14 dhe 15 do të emërtohen “Sigurimi i kreditit dhe i garancisë”.

8. Klasat nr. 19, 20, 21, 22 dhe 23 do të emërtohen “Sigurimi i jetës”.

C. Klasat e sigurimeve të parashikuara në paragrafin A të këtij neni do të grupohen si më poshtë:

1. Sigurimi jo-jetës mbulon klasat e sigurimeve nga 1 deri 18 të paragrafit A të këtij neni.

2. Sigurimi i jetës mbulon klasat nga 19 deri 23 të paragrafit A të këtij neni.

Neni 8

E drejta për të ushtruar veprimtari sigurimi

1. Veprimtaria e sigurimit ushtrohet nga:

a) shoqëria e sigurimit me seli qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, e licencuar nga Autoriteti;

b) dega e shoqërisë së huaj të sigurimit e licencuar nga Autoriteti.

2. Veprimtaria e sigurimit nuk lejohet të ushtrohet nga asnjë person tjetër juridik, përveç atyre të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 9

Veprimtaria e shoqërisë së sigurimit

1. Shoqëria që ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jetës, parashikuar në paragrafin C të nenit 7 të këtij ligji, nuk ushtron në të njëjtën kohë veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jo-jetës dhe anasjelltas.

2. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, shoqëria e risigurimit mund të ushtrojë veprimtari risigurimi për klasat e jetës dhe jo-jetës.

Neni 10

Sigurimi për rreziqet aksesore

1. Shoqëria e sigurimit, që është licencuar për të ushtruar veprimtarinë sigurimit të jetës në klasat 19 dhe 21 të nenit 7, në përjashtim nga pika 1e nenit 9 të këtij ligji, mund të autorizohet nga Autoriteti të bëjë drejtpërsëdrejti sigurime aksesore për rreziqe që i përkasin klasave të sigurimeve 1 dhe 2, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji, përkatësisht rreziqet e dëmtimeve trupore, që përfshijnë paaftësinë profesionale, vdekjen aksidentale ose invaliditetin e rrjedhur nga

aksidenti ose sëmundja.

2. Shoqëria e sigurimit, që është licencuar për të ushtruar veprimtarinë e sigurimit të jo-jetës për një ose disa klasa sigurimi, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji, mbulon rreziqet aksesore që përfshihen në një klasë tjetër, në qoftë se përmbushen kushtet që vijojnë:

- a) rreziqet aksesore të jenë të lidhura me rrezikun kryesor;
- b) rreziqet aksesore t'i përkasin objektit që është mbuluar kundër rrezikut kryesor;
- c) rreziqet aksesore të jenë të garantuara nga kontrata që mbulon rrezikun kryesor.

3. Rreziqet e përfshira në klasat 14 dhe 15, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji, nuk konsiderohen rreziqet aksesore të klasave të tjera të sigurimit.

Neni 11

Kontributet dhe komisionet

1. Shpenzimet e çdo natyre për mbikëqyrjen nga ana e shtetit të veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, përballohen nga kontributet e shoqërive të sigurimit dhe degët e shoqërive të huaja të sigurimit.

2. Kontributet janë deri në 1,5 për qind e shumës:

- a) të primeve bruto të shkruara për shoqëritë e sigurimit të jo-jetës;
- b) të rreziqeve dhe elementeve të shpenzimeve të kuotave të fituara gjatë vitit financiar për shoqëritë e sigurimit të jetës. Rreziku dhe elementet e shpenzimeve të kuotave të sigurimit të jetës llogariten nga aktuari i shoqërisë së sigurimit të jetës dhe janë të barabarta me totalin e kuotave, pasi janë zbritur elementet e kursimit.

3. Kontributet derdhen në llogarinë e Autoritetit nga çdo shoqëri sigurimi ose degë e shoqërisë së huaj të sigurimit çdo muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës. Derdhja bëhet në llojin e monedhës që arkëtohet primi ose kuota e sigurimit. Në fund të çdo viti financiar Autoriteti bën rakordimin përkatës me shoqëritë ose degët e shoqërive të huaja.

4. Autoriteti zbaton komisione për përballimin e shpenzimeve të shqyrtimit dhe të korrespondencës për dhënie dhe rinovim licencash, autorizime dhe miratime. Komisionet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Byroja Shqiptare e Sigurimit

Shoqëria e sigurimit, e licencuar për të ushtruar veprimtari në sigurimet motorike, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, përpara fillimit të veprimtarisë bëhet anëtare e Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS).

Neni 13

Shoqatat profesionale

Shoqëritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësit, aktuarët dhe vlerësuesit e dëmeve mund të bashkohen në shoqata profesionale, si dhe të bëhen anëtarë të shoqatave ndërkombëtare.

KREU II

SHOQËRITË E SIGURIMIT

Neni 14

Themelimi i shoqërisë së sigurimit - Forma juridike

Shoqëria e sigurimit themelohet si shoqëri anonime, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin “Për shoqëritë tregtare”, përveç rasteve kur

në këtë ligj është parashikuar ndryshe.

Neni 15

E drejta për të marrë pjesë si aksioner në një shoqëri sigurimi

1. Aksioner i një shoqërie sigurimi është personi fizik ose juridik që plotëson kërkesat e këtij ligji dhe kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti.

2. Aksioner i një shoqërie sigurimi në themelim e sipër nuk lejohet të jetë një person që është subjekt i procedurave të likuidimit dhe falimentimit.

3. Aksioner i një shoqërie sigurimi në themelim e sipër nuk lejohet të jetë një person, të cilit me ligj i është ndaluar të jetë themelues i një shoqërie tregtare.

Neni 16

Pjesëmarrja influencuese

1. Pjesëmarrja influencuese nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të aksioneve në një shoqëri sigurimi nga një person fizik ose juridik, në bazë të të cilave personi fizik ose juridik zotëron jo më pak se 10 për qind ose më shumë se 10 për qind të aksioneve me të drejtë vote në kapitalin e shoqërisë, pjesëmarrje, e cila i jep të drejtën e vendimmarrjes në këtë shoqëri sigurimi.

2. Zotërues jo i drejtpërdrejtë i aksioneve dhe i të drejtave të votës është një person, i cili, në emër të personit tjetër, ka përfituar aksione ose të drejtë vote.

3. Një person konsiderohet zotërues jo i drejtpërdrejtë i aksioneve dhe i të drejtës së votës nëse zotëruesi i drejtpërdrejtë i tyre është i lidhur me atë person, në cilësinë e bashkëshortit, prindit ose fëmijës.

4. Në kuptim të pikës 3 të këtij neni, konsiderohen persona të lidhur me njëri-tjetrin, kur njëri prej tyre është bashkëshorti, prindi ose fëmija e tij.

Neni 17

Kapitali themeltar

1. Shoqëria e sigurimit duhet të ketë një kapital themeltar, pa përfshirë kontributet në natyrë, jo më të vogël se vlerat e përcaktuara të fondit të garancisë, të parashikuara në nenin 98 të këtij ligji.

2. Shoqëria e sigurimit, përveç kapitalit themeltar të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të ketë edhe fond shtesë për të mbuluar shpenzimet e themelimit, të funksionimit dhe të administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se 5 për qind e kapitalit themeltar. (Më poshtë i quajtur “fond për shpenzime nisje”).

3. Çdo aksioner duhet të depozitojë për llogari të shoqërisë që kërkon të licenohet, vlerat respektive të kapitalit themeltar në mjete monetare të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, si dhe fondin për shpenzimet e nisjes, sipas pikës 2 të këtij neni, në një llogari qëllimore, në njërin nga bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku shoqëria do të ketë selinë qendrore të saj.

4. Në kuptim të pikës 3 të këtij neni, depozitimi evidentohet nga një certifikatë bankare e hartuar në momentin e kryerjes së depozitimit të fondeve, sipas listës së aksionerëve, ku janë evidentuar shumat e depozituara nga secili prej tyre.

5. Shoqëria, që kërkon të licenohet, për çdo aksioner, jep informacion në Autoritet për burimin e kapitalit themeltar. Autoriteti, për burimin e kapitalit themeltar, bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe merr konfirmimin e saj.

6. Kapitali themeltar i shoqërisë së sigurimit duhet të përbëhet të paktën në dy të tretat e tij nga mjete monetare.

7. Pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, aksionet e shoqërisë së sigurimit detyrimisht regjistrohen në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve në Republikën e Shqipërisë. Çdo ndryshim që pëson kapitali i shoqërisë së sigurimit gjatë veprimtarisë, regjistrohet në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve.

Neni 18

Burimi i kapitalit themeltar

1. Çdo aksioner jep informacion për burimin e kapitalit themeltar, sipas kriterëve të përcaktuara nga Autoriteti.
2. Kapitali themeltar nuk përbëhet nga:
 - a) hua nga publiku;
 - b) kredi nga banka;
 - c) dhe paradhënie nga subjekte dhe palë të treta.

Neni 19

Përfundimi nga detyrimi për rezervën e domosdoshme

Shoqëria e sigurimit përfundohet nga detyrimi i krijimit të rezervës së domosdoshme të parashikuar në ligjin “Për shoqëritë tregtare”.

KREU III

LICENCIMET, MIRATIMET DHE NJOFTIMET

SEKSIONI I

LICENCIMI I SHOQËRISË SË SIGURIMIT DHE DEGËS SË SHOQËRISË SË HUAJ

Neni 20

Licenca

1. Për të ushtruar veprimtari sigurimi, shoqëria dhe dega e shoqërisë së huaj duhet të licencohen nga Autoriteti.
2. Shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi vetëm për klasat që është licencuar nga Autoriteti.
3. Shoqëria licencohet si:
 - a) shoqëri sigurimi ose degë e shoqërisë së huaj;
 - b) shoqëri risigurimi ose degë e shoqërisë së huaj;
 - c) shoqëri sigurimi dhe risigurimi ose degë e shoqërisë së huaj sigurimi dhe risigurimi.
4. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patregtueshme.
5. Licenca jepet për një klasë sigurimesh dhe mbulon tërë klasën, përveç rasteve kur shoqëria kërkon të mbulojë vetëm një pjesë të rreziqeve që i përkasin klasës së sigurimeve sipas parashikimeve të shkronjës “A” neni 7 të këtij ligji.
6. Licenca jepet edhe sipas klasikimit të parashikuar në shkronjën “B” të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 21

Llojet e licencave

1. Shoqëria e sigurimit pajiset me licencë për ushtrim veprimtarie nga “Autoriteti” (këtu më poshtë: licencë për ushtrim veprimtarie).

2. Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj pajiset me licencë nga Autoriteti për çdo klasë të re sigurimi, përtej atyre për të cilat ajo ka qenë e licencuar më parë (më poshtë “licencë për zgjerim veprimtarie”).

3. Një shoqëri e huaj sigurimi pajiset me licencë nga Autoriteti për krijimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së degës së saj në Republikën e Shqipërisë (më poshtë “licencë për ushtrim veprimtarie të degës së shoqërisë së huaj”).

4. Autoriteti vendos komisione për shpenzimet e përpunimit, korrespondencave zyrtare, verifikimeve të ndryshme të domosdoshme për dhënien e licencave. Këto komisione nuk rimbursohen.

Neni 22

Fazat e licencimit

1. Licencimi i veprimtarisë së sigurimit përfshin dy faza:

- a) miratimin paraprak;
- b) licencën.

2. E drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit lind vetëm pasi shoqëria dhe dega e shoqërisë së huaj të sigurimit janë pajisur me licencë nga Autoriteti.

Neni 23

Kërkesat e licencimit “për ushtrim veprimtarie”

1. Shoqëria e sigurimit paraqet pranë Autoritetit një kërkesë me shkrim për ushtrim veprimtarie sigurimi, e cila shoqërohet me:

- a) aktin e themelimit;
- b) projektstatutin;
- c) emrin e propozuar dhe adresën e selisë qendrore të saj;
- ç) listën e aksionerëve, të dhëna për llojin e aksioneve, të dhëna për vlerën nominale të aksioneve, përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin aksioner dhe vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatim-taksave nga aksionerët;
- d) informacion për burimin e kapitalit të aksionerëve sipas formës së përcaktuar nga Autoriteti me rregullore të tij;
- dh) programin e veprimtarisë, të hartuar në përputhje me nenin 24;
- e) listën e anëtarëve të propozuar të organeve drejtuese, shoqëruar me informacionin përkatës, në përputhje me kërkesat e kreut IV të këtij ligji;
- ë) strukturën organizative në qendër dhe në degë së bashku me listën e personave të propozuar për drejtuesit kryesorë në qendër;
- f) vërtetimin e depozitimit të gjysmës së kapitalit themeltar të parashikuar në nenin 17 të këtij ligji;
- g) projektkontratat për dhënien në sipërmarrje të funksioneve të veçanta të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit të tretëve, në qoftë se shoqëria ka planifikuar sipërmarrje të tilla;
- gj) emrat e bankave me të cilat do të operojë.

2. Autoriteti ka të drejtë të kërkojë informacione të tjera shtesë, përveç sa parashikohet më sipër, mosdhënia e të cilave përbën shkak për refuzimin e miratimit paraprak të licencës.

Neni 24

Programi i veprimtarisë

1. Programi i veprimtarisë, i parashikuar në pikën 1 shkronja “dh” të nenit 23, hartohet për tre vitet e para dhe përmban:

- a) klasat e sigurimeve, për të cilat kërkon të licencohet;
- b) parashikimet për kalimet në risigurime, duke përfshirë tabelat e mbulimeve maksimale për të gjitha klasat e sigurimeve;
- c) llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë pagueuse;
- ç) elementet që përbëjnë fondin e garancisë;
- d) parashikimi i detajuar i shpenzimeve të nisjes;
- dh) kushtet e përgjithshme të kontratave të sigurimit për klasat që kërkon të licencohet;
- e) tarifatat dhe primet që parashikon të zbatojë për klasat që kërkon të licencohet dhe mënyrat e llogaritjes së tyre;
- ë) planin e biznesit.

2. Plani i biznesit për tre vitet e para përmban:

- a) formën e shkurtuar të bilancit dhe pasqyrat financiare;
- b) parashikimet për primet dhe dëmshpërblimet;
- c) pasqyrën e rrjedhjes së parasë;
- ç) burimet financiare për të përmbushur detyrimet që do të marrë përsipër shoqëria dhe për të mbajtur nivelin e kërkuar të aftësisë pagueuse;
- d) fitimin e parashikuar;
- dh) llogaritjen e provigjoneve teknike dhe metodat e përdorura për llogaritjen e tyre.

Për klasën 18 të nenit 7 të këtij ligji jepen të dhëna për mjetet materiale, personelin, si dhe mjetet financiare të destinuara për përballimin e këtyre shpenzimeve.

3. Shoqëria që kërkon të ushtrojë veprimtari në sigurimin e jetës dhe sigurimeve aksesore, të parashikuara në pikën 1 të nenit 10 të këtij ligji, harton programin e veprimtarisë për shtatë vitet e para.

4. Për operacionet e sigurimit që përmbajnë detyrime, zbatimin e të cilave varet nga kohëzgjatja e jetës dhe operacionet e lidhura me sigurime aksesore të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji, shoqëria e sigurimit paraqet në programin e veprimtarisë të dhënat shtesë si më poshtë:

- a) tarifatat që u përkasin rreziqeve kryesore dhe aksesore për të gjitha operacionet;
- b) bazat teknike dhe metodat aktuariale të zbatuara për llogaritjen e primeve ose kuotave për dëmshpërblimin dhe rezervat matematike.

Këto të dhëna duhet të jenë të nënshkruara nga aktuarë të certifikuar.

5. Nëse shoqëria kërkon të licencohet si shoqëri risigurimi, programi i veprimtarisë përmban parimet drejtuese të politikës së risigurimeve.

Neni 25

Afati i shqyrtimit

1. Autoriteti brenda 6 muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë, jep ose refuzon miratimin paraprak dhe njofton me shkrim shoqërinë për vendimin e tij.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, data e pranimit të kërkesës për licencë është data kur shoqëria ka plotësuar të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe rregulloreve të Autoritetit.

Neni 26

Miratimi paraprak ose refuzimi i tij

1. Autoriteti jep miratimin paraprak në rast se shoqëria ka plotësuar kërkesat e këtij ligji, rregulloreve të tij dhe rezulton se:

- a) ka plotësuar kërkesat e nenit 14 të këtij ligji;
- b) ka kufizuar objektin e veprimtarisë, të parashikuar në nenin 4 të këtij ligji;
- c) zotëron fondin e garancisë;

- ç) aksionerët kanë plotësuar kërkesat e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji;
 - d) anëtarët e propozuar të drejtorisë së shoqërisë përbushin kërkesat e parashikuara në nenet 62 dhe 64 të këtij ligji;
 - dh) dokumentet e paraqitura nga shoqëria janë të sakta;
 - e) programi i veprimtarisë është hartuar në përputhje me nenin 24 të këtij ligji;
 - ë) llogaritjet e primeve dhe të provigjoneve teknike ose matematike janë të mjaftueshme.
2. Autoriteti refuzon miratimin paraprak në rast se shoqëria nuk ka përbushur kushtet e kërkuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3. Autoriteti shpjegon arsyet, në bazë të të cilave informacioni i paraqitur nga shoqëria vlerësohet i pamjaftueshëm dhe përbën shkak për refuzimin e miratimit paraprak.

Neni 27

Njoftimi i vendimit

1. Vendimi i Autoritetit për miratim ose refuzim paraprak duhet të jetë i arsyetuar dhe i bëhet i ditur shoqërisë me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së vendimit përkatës.
2. Në rastin e refuzimit të miratimit paraprak nga Autoriteti shoqëria mund të ankimohet, sipas parashikimeve të bëra në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 28

Regjistrimi në gjykatë

Pas marrjes së miratimit paraprak, shoqëria regjistrohet në regjistrin tregtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, si shoqëri sigurimi.

Neni 29

Licenca për “ushtrim veprimtarie sigurimi”

1. Shoqëria e sigurimit pajiset me licencë për “ushtrim veprimtarie sigurimi”, pasi të ketë depozituar në Autoritet sa më poshtë:
- a) vendimin e regjistrimit në gjykatë së bashku me aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë së sigurimit, të depozituara në regjistrin tregtar;
 - b) vërtetimin e depozitimit të gjysmës tjetër të kapitalit themeltar dhe të fondit të shpenzimeve të nisjes, të parashikuar në nenin 17 të këtij ligji;
 - c) vërtetimin e pronësisë ose të kontratës së qirasë për mjediset ku do të ushtrohet veprimtaria e sigurimit;
 - ç) aktin e emërimit të anëtarëve të drejtorisë dhe të këshillit mbikëqyrës së bashku me një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tyre, si dhe specimenet e nënshkrimit;
 - d) aktin e emërimit të ekspertit kontabël të autorizuar, sipas nenit 71 të këtij ligji;
 - dh) specimenet e kontratave të sigurimit, sipas klasave, të kërkuara prej saj.
2. Autoriteti, përveç kërkesave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë në lidhje me dokumentacionin e paraqitur, mosdhënia e të cilave mund të përbëjë shkak për refuzimin e licencës.

Neni 30

Afati i shqyrtimit

1. Autoriteti shqyrton kërkesën për licencim brenda dy muajve nga data e depozitimit të dokumenteve të plotësuar, sipas nenit 29 të këtij ligji, dhe merr vendim.
2. Autoriteti ka të drejtë të shtyjë afatin e shqyrtimit të kërkesës së parashikuar në pikën 1

të këtij neni deri në tre muaj, në raste objektivisht të vërtetueshme, për të cilat Autoritetit i duhet koha e nevojshme për shqyrtim.

Neni 31

Miratimi ose refuzimi i licencës

1. Autoriteti e jep licencën në rast se shoqëria ka plotësuar kërkesat e nenit 29 të këtij ligji ose e refuzon atë nëse nuk janë përmbushur këto kërkesa.

2. Në rastin e refuzimit të licencës nga Autoriteti, shoqëria mund të ankimohet, sipas parashikimeve të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 32

Publikimi i vendimit për dhënien e licencës

1. Vendimi për dhënien e licencës për ushtrim veprimtarie botohet në Fletoren Zyrtare. Autoriteti dërgon për botim vendimin për dhënien e licencës brenda pesë ditëve kalendarike nga marrja e vendimit. Vendimi për dhënien e licencës hyn në fuqi menjëherë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

2. Shoqëria e sigurimit informon me shkrim Autoritetin për datën e fillimit të veprimtarisë së saj.

3. Shoqëria e sigurimit fillon punë brenda 6 muajve nga data e marrjes së licencës.

Neni 33

Tërheqja e licencës për “ushtrim veprimtarie”

1. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit tërhiqet në rastet e mëposhtme:

a) kur shoqëria e sigurimit nuk fillon veprimtarinë brenda një periudhe 6-mujore nga data e hyrjes në fuqi të licencës;

b) kur shoqëria e sigurimit pezullon veprimtarinë për një periudhë më të gjatë se 6 muaj;

c) kur shoqëria e sigurimit i nënshtrohet procedurave të falimentimit;

ç) kur shoqëria e sigurimit i nënshtrohet procedurave të likuidimit;

d) kur transferohen tërësisht kontratat e sigurimit në një shoqëri tjetër sigurimi;

dh) kur shoqëria e sigurimit heq dorë vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë;

e) kur vërtetohet se dokumentet e depozituara për dhënien e licencës janë të falsifikuara ose të rreme.

2. Autoriteti merr vendim për tërheqjen e licencës në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni dhe njofton shoqërinë e sigurimit brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

3. Shoqëria e sigurimit, me marrjen e njoftimit për tërheqjen e licencës për ushtrim veprimtarie:

a) depoziton në Autoritet licencën brenda 10 ditëve kalendarike;

b) nuk lidh kontrata të reja sigurimi;

c) nuk ripërtërin kontrata sigurimi;

ç) nuk zgjeron mbulimin në sigurim për kontratat në fuqi;

d) nuk rrit shumën e sigurimit ose të risigurimit;

dh) bën çregjistrimin në gjykatë.

Neni 34

Publikimi

Vendimi për tërheqjen e licencës për ushtrim veprimtarie botohet në Fletoren Zyrtare. Autoriteti dërgon vendimin për botim brenda 5 ditëve nga data e marrjes së tij.

Neni 35

Licenca për “zgjerim veprimtarie”

1. Shoqëria e sigurimit apo dega e shoqërisë së huaj, e cila ka marrë licencë për “ushtrim veprimtarie” sigurimi për një ose disa klasa, duhet të marrë nga Autoriteti licencë për “zgjerim veprimtarie” për të ushtruar veprimtari në klasa të tjera sigurimi, përveç atyre për të cilat është licencuar më parë.

2. Kërkesa për licencim për “zgjerim veprimtarie” bëhet me shkrim e shoqëruar me:

- a) vendimin e asamblesë së aksionerëve për zgjerimin e veprimtarisë;
- b) klasat të cilat kërkon të ushtrojë;
- c) burimin për shtimin e kapitalit, në përputhje me nenin 18, për klasat që kërkon të licencohet;
- ç) depozitimin e shtesës së kapitalit themeltar, sipas klasave të sigurimit që do të kërkojë të ushtrojë;
- d) projektin për ndryshimin e statutit;
- dh) vërtetimin për zotërimin e fondit të garancisë, në përputhje me klasat që kërkon të licencohet;
- e) vërtetimin për zotërimin e nivelit të aftësisë paguese, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- ë) programi shtesë i veprimtarisë, i hartuar në përputhje me nenin 24 të këtij ligji.

Neni 36

Afati i shqyrtimit

1. Autoriteti brenda tre muajve nga data e depozitimit të kërkesave të plotësuar sipas nenit 35, miraton ose refuzon licencën për “zgjerim veprimtarie” sigurimi.

2. Autoriteti ka të drejtë të shtyjë afatin e shqyrtimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni deri në 1 muaj, në raste objektive të vërtetueshme, për të cilat Autoritetit i duhet koha e nevojshme.

Neni 37

Miratimi ose refuzimi i licencës për “zgjerim veprimtarie”

1. Autoriteti miraton licencën në rast se shoqëria ka plotësuar kërkesat e nenit 35 të këtij ligji.

2. Autoriteti refuzon kërkesën për licencë për “zgjerim veprimtarie” në rast se:

- a) konstaton se me shtimin e klasave të reja të sigurimit veprimtaria e shoqërisë së sigurimit do të rrezikohet, sipas rregullave të parashikuara në kreun VI të këtij ligji;
- b) nuk ka plotësuar kërkesat e parashikuara në nenin 35 të këtij ligji;
- c) nuk plotëson kërkesat ligjore për të ushtruar veprimtari sigurimi për klasat e sigurimeve, për të cilat është licencuar më parë.

Neni 38

Njoftimi i vendimit dhe publikimi

1. Vendimi i Autoritetit për miratimin ose refuzimin e licencës për “zgjerim veprimtarie”

duhet të jetë i arsyetuar dhe i bëhet i ditur shoqërisë së sigurimeve ose degës së shoqërisë së huaj me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit përkatës.

2. Vendimi dërgohet për publikim brenda pesë ditëve kalendarike nga marrja e tij. Vendimi për dhënien e licencës për zgjerim veprimtarie hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 39

Licenca për “ushtrim veprimtarie të degës së shoqërisë së huaj”

1. Shoqëria e huaj e sigurimit paraqet në Autoritet një kërkesë me shkrim në gjuhën shqipe për licencimin e degës së saj, të shoqëruar me:

a) vendimin e organit më të lartë drejtues të shoqërisë së huaj të sigurimit për hapjen e degës në Republikën e Shqipërisë;

b) vërtetimin se shoqëria ka ushtruar veprimtari sigurimi të paktën 5 vjet në shtetin e origjinës;

c) vendimin e emërimit të administratorit të degës, kompetencat e tij për përfaqësimin në marrëdhëniet me organet shtetërore dhe gjykatat shqiptare;

ç) aktin e themelimit të shoqërisë dhe statutin e saj;

d) licencën për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit, dhënë nga autoriteti përkatës në vendin ku ndodhet selia e saj;

dh) miratimin zyrtar për hapjen e degës së shoqërisë së huaj, dhënë nga autoriteti mbikëqyrës i vendit ku ndodhet selia qendrore e saj;

e) programin e veprimtarisë së degës, të hartuar sipas kërkesave të nenit 24 të këtij ligji;

ë) raportet financiare të shoqërisë për tre vjetët e fundit të revizionuara, sipas kritereve të autoritetit mbikëqyrës të sigurimeve në vendin ku ndodhet selia e saj;

f) vërtetimin që ka vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë aktive me vlerë të barabartë me 1/2 e fondit minimal të garancisë, depozitim të 1/4 së këtij fondi në mjete monetare në një bankë që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, të kthyeshme në raste të moslicencimit;

g) deklaratën në lidhje me marrëdhëniet financiare midis degës dhe shoqërisë së huaj;

gj) deklaratën për mbajtjen e të gjithë dokumentacionit të brendshëm dhe korrespondencës midis degës dhe shoqërisë mëmë në gjuhën shqipe;

2. Dokumentet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni paraqiten në gjuhën shqipe.

3. Dega mban një kontabilitet të veçantë për veprimtarinë që ushtron në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ruan të gjitha dokumentet që lidhen me këtë veprimtari.

Neni 40

Administratori i degës së shoqërisë së huaj

Administratori i degës së shoqërisë së huaj duhet të jetë person rezident në Republikën e Shqipërisë, duke plotësuar këto kritere:

a) arsim të lartë;

b) përvojë jo më pak se tre vjet në drejtimin e shoqërive të sigurimit ose institucioneve financiare;

c) kualifikim profesional;

ç) dëshmi që nuk është dënuar;

d) të mos ketë pengesa ligjore për ushtrimin e këtij funksioni.

Neni 41

Vendimi për dhënien e licencës degës së shoqërisë së huaj

Për dhënien ose refuzimin e licencës për degën e shoqërisë së huaj të sigurimit janë të zbatueshme nenet 20,21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32 dhe 33 të këtij ligji.

Neni 42

Regjistrimi në regjistrin e Autoritetit

1. Autoriteti mban regjistër të veçantë, ku për secilën shoqëri apo degë të shoqërisë së huaj të licencuar, regjistrohet emri, adresa e vendndodhjes së selisë të shoqërisë apo degës së shoqërisë së huaj, numri i licencës, data e dhënies së licencës, klasat për të cilat është licencuar, aksionerët, pjesëmarrjet e tyre në kapitalin e shoqërisë, si dhe çdo ndryshim që pëson shoqëria gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

2. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj me licencë të tërhequr çregjistrohen nga regjistri i Autoritetit.

SEKSIONI II MIRATIMET

Neni 43

Miratimi ose refuzimi i kërkesës për ushtrim veprimtarie jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Shoqëria e sigurimit, për të ushtruar veprimtari sigurimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të marrë më parë miratimin e Autoritetit.

2. Kërkesa e shoqërisë së sigurimit bëhet me shkrim, duke u shoqëruar me:

- a) vendimin e asamblesë së aksionerëve për shtrirjen e veprimtarisë jashtë territorit;
- b) shumën e investimit dhe burimin e financimit;
- c) formën juridike të investimit (degë, filial);
- ç) klasat e sigurimit që kërkon të ushtrojë veprimtari;
- d) dokumente të tjera të kërkuara nga Autoriteti.

3. Autoriteti, brenda një periudhe tre mujore, shqyrton dhe merr vendim në lidhje me kërkesën e shoqërisë për ushtrim veprimtarie jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. Autoriteti njofton me shkrim shoqërinë e sigurimit brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit për miratimin ose refuzimin e kërkesës.

Neni 44

Miratimi ose refuzimi i kërkesës për hapje zyre përfaqësimi të shoqërisë së huaj

1. Shoqëria e huaj, për hapjen e zyrës së përfaqësimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kërkesë me shkrim në gjuhën shqipe dhe e paraqet në Autoritet të shoqëruar me:

- a) vendimin e organit më të lartë;
- b) aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë së huaj;
- c) licencën e shoqërisë së sigurimit, dhënë nga autoriteti mbikëqyrës i vendit ku ndodhet selia e saj;
- ç) vendimin e shoqërisë së huaj të sigurimit për emërimin e përfaqësuesit të zyrës;

2. Dokumentacioni i kërkuar në pikën 1 të këtij neni paraqitet në gjuhën shqipe.

3. Autoriteti, brenda një periudhe një mujore, shqyrton dhe merr vendim në lidhje me

kërkesën e shoqërisë së huaj për zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë.

4. Autoriteti njofton me shkrim shoqërinë e sigurimit të huaj brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit për miratimin ose refuzimin e kërkesës.

5. Zyra e përfaqësimit regjistrohet në gjykatë pasi ka marrë miratimin nga Autoriteti.

Neni 45

Transferimi i portofolit të sigurimit

1. Shoqëria e sigurimit apo dega e shoqërisë së huaj mund të transferojë me marrëveshje të një ose disa shoqëri sigurimi të tjera të licencuara, me miratim të Autoritetit, tërësinë ose një pjesë të portofolit të kontratave të tyre me të gjitha detyrimet dhe të drejtat.

2. Shoqëria e sigurimit apo dega e shoqërisë së huaj lidh marrëveshje me një shoqëri tjetër sigurimi (shoqëri pranuese) për transferimin e kontratave të sigurimit ose të portofolit të sigurimit.

3. Kërkesa për transferim u bëhet e ditur kreditorëve me një lajmërim në Fletoren Zyrtare, duke i lënë një afat prej 1 muaji nga data e botimit për të zgjidhur kontratat e tyre.

4. Shoqëria e sigurimit apo dega e shoqërisë së huaj, përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, transferon edhe aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike të barabarta me provigjonet teknike dhe matematike të përlllogaritura për të mbuluar përgjegjësitë e portofolit të sigurimit që do të transferohet.

Transferimi i portofoleve të sigurimit nuk kërkon miratimin e të siguruarve. Autoriteti miraton transferimin nëse e çmon se është në pajtim me interesat e kreditorëve dhe të të siguruarve.

5. Marrëveshja që i referohet pikës 1 të këtij neni do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Autoriteti miraton transferimin e portofolit të sigurimit.

6. Shoqëria e sigurimit, që pranon portofolin e transferuar të sigurimit, njofton të siguruarit brenda 10 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Autoritetit për miratimin e transferimit të portofolit, nëpërmjet publikimit në të paktën dy gazeta të përditshme kombëtare për 5 ditë të njëpasnjëshme.

7. Shoqëria e sigurimit transferon portofolin e sigurimit:

a) në shoqëri të tjera sigurimi me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) në degë të shoqërive të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 46

Kërkesa për transferimin e portofolit të sigurimit

Kërkesa për transferimin e portofolit të sigurimit bëhet me shkrim nga shoqëria transferuese ose dega e shoqërisë së huaj dhe i paraqitet Autoritetit duke u shoqëruar me:

a) miratimin e transferimit nga organet vendimmarrëse të shoqërisë transferuese;

b) miratimin e organeve vendimmarrëse të shoqërisë pranuese;

c) listën e kontratave të sigurimit, sipas klasave që do të transferohen, afatet, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të tyre dhe llogaritjet përkatëse të provigjoneve teknike dhe matematike;

ç) listën e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, shoqëruar me aktin e vlerësimit të tyre nga ekspertë të licencuar dhe kërkesa të tjera të përcaktuara nga Autoriteti, në bazë të të cilave mund të kontrollohet vlera e aktiveve në momentin e transferimit;

d) plani i ndryshuar i biznesit i shoqërisë pranuese të portofolit të sigurimit, si rezultat i transferimit;

dh) marrëveshja e lidhur për transferimin e portofolit të sigurimit dhe arsyet e një transferimi të tillë;

e) një raport të hartuar nga një aktuar i autorizuar nga Autoriteti, në rastin e transferimit të portofolit të sigurimit të jetës, që vërteton se transferimi nuk është në kundërshtim me interesat e policëmbajtësve dhe të shoqërisë pranuese të sigurimit.

Neni 47

Afati i shqyrtimit

Autoriteti brenda tre muajve nga data e depozitimit të dokumentacionit, shqyrton kërkesën për transferimin e portofolit të sigurimit dhe merr vendim për miratimin ose refuzimin e kërkesës.

Neni 48

Miratimi ose refuzimi i kërkesës

1. Autoriteti miraton transferimin e portofolit të sigurimit në qoftë se shoqëria transferuese ka plotësuar kërkesat e nenit 46 të këtij ligji dhe shoqëria pranuese zotëron, duke marrë parasysh dhe transferimin e portofolit, një nivel aftësie paguese, të barabartë me atë të kërkuar, si dhe fondin e garancisë.

2. Në rastin kur shoqëria pranuese është degë e një shoqërie të huaj, Autoriteti merr vendim, vetëm nëse autoriteti mbikëqyrës i vendit të origjinës jep miratimin me shkrim për sa më sipër.

3. Autoriteti refuzon kërkesën për transferimin e portofolit në qoftë se vlera e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike është më e ulët sesa vlera e provigjoneve që duhet të depozitoheshin përkundëjt portofolit të sigurimit që do të transferohet ose kur Autoriteti çmon se ky transferim rrezikon interesat e të siguruarve.

4. Autoriteti refuzon kërkesën për transferimin e portofolit të sigurimit në qoftë se shoqëria pranuese nuk plotëson kërkesat ligjore për klasat e sigurimeve që i përkasin portofolit që transferohet, ose në qoftë se me pranimin e portofolit gjendja financiare e shoqërisë pranuese përkeqësohet.

5. Autoriteti refuzon kërkesën nëse shoqëria pranuese nuk është e licencuar për ushtrimin e veprimtarisë në klasat e sigurimeve që i përkasin portofolit të sigurimit që transferohet.

6. Autoriteti, brenda një muaji nga data e depozitimit të kërkesave të plotësuara, sipas parashikimeve të nenit 46 të këtij ligji, miraton ose refuzon transferimin e portofolit të sigurimit.

Neni 49

Njoftimi i vendimit

1. Vendimi i Autoritetit për miratimin ose refuzimin e transferimit të portofolit të sigurimit duhet të jetë i argumentuar dhe i bëhet e ditur shoqërisë së sigurimit ose degës së shoqërisë së huaj me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit përkatës.

2. Vendimi për transferimin e portofolit të sigurimit dërgohet për publikim në Fletoren Zyrtare brenda pesë ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

3. Vendimi për transferimin e portofolit të sigurimit hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 50

Dhënia në sipërmarrje e disa funksioneve të shoqërisë së sigurimit

1. Një shoqëri sigurimi ose degë e shoqërisë së huaj ka të drejtë të lidhë marrëveshje me një shoqëri tjetër sigurimi, me një person fizik ose juridik, për kalimin në sipërmarrje të funksioneve të veçanta të veprimtarisë së saj.

2. Për qëllime të këtij ligji, do të konsiderohen funksione të veçanta:

- a) trajtimi i dëmeve;
- b) menaxhimi i aktiveve të shoqërisë së sigurimit në mbulim të provigjoneve teknike ose aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike;
- c) mbajtja e kontabilitetit;
- ç) shërbime aktuariale;
- d) informatizimi;
- dh) të tjera.

Neni 51

Kërkesa për dhënien në sipërmarrje

1. Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj, për dhënien në sipërmarrje të funksioneve të veçanta të veprimtarisë së saj, bën kërkesë me shkrim tek Autoriteti të shoqëruar me:

- a) projektkontratën e sipërmarrjes, të përfunduar midis shoqërisë së sigurimit ose degës së shoqërisë së huaj dhe personit fizik apo juridik;
- b) dokumente dhe të dhëna të tjera shtesë të kërkuara nga Autoriteti.

2. Autoriteti, brenda një periudhe njëmuajore, shqyrton dhe merr vendim në lidhje me kërkesën e shoqërisë së sigurimit ose degës së shoqërisë së huaj për dhënien në sipërmarrje të funksioneve të veçanta të saj.

3. Autoriteti njofton me shkrim shoqërinë e sigurimit ose degën e shoqërisë së huaj brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

Neni 52

Miratimi ose refuzimi i dhënies në sipërmarrje

1. Autoriteti miraton dhënien në sipërmarrje të funksioneve të veçanta të shoqërisë së sigurimit në qoftë se plotësohen kërkesat e parashikuara në nenin 51 të këtij ligji.

2. Autoriteti refuzon dhënien në sipërmarrje në qoftë se rrezikohen interesat e të siguruarve.

3. Autoriteti refuzon dhënien në sipërmarrje, në qoftë se vështirësohet ose bëhet e pamundur mbikëqyrja e veprimtarisë së sigurimit.

Neni 53

Mbikëqyrja e funksioneve të veçanta të dhëna në sipërmarrje

1. Dispozitave të këtij ligji për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit ose degës së shoqërisë së huaj u nënshtrohen edhe personat fizikë apo juridikë që do të kryejnë funksione të veçanta të dhëna në sipërmarrje.

2. Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj, me kërkesën e Autoritetit paraqet të dhëna në lidhje me statusin juridik, gjendjen financiare dhe veprimtarinë e personit juridik, me të cilin ka nënshkruar një kontratë për dhënien në sipërmarrje.

3. Autoriteti revokon miratimin e dhënë më parë nëse:

- a) rrezikohen interesat e të siguruarve.
- b) vështirësohet ose bëhet e pamundur mbikëqyrja e veprimtarisë së sigurimit.

Neni 54

Miratimi ose refuzimi për bashkimin ose ndarjen e shoqërisë së sigurimit

1. Bashkimi ose ndarja e shoqërisë së sigurimit bëhet vetëm me miratimin e Autoritetit.
2. Për shoqëritë e sigurimit të jetës duhet të paraqitet në Autoritet një raport i hartuar nga një aktuar i autorizuar nga Autoriteti, që vërteton se bashkimi ose ndarja nuk është në kundërshtim me interesat e policëmbajtësve, të shoqërisë së sigurimit dhe të shoqërive të përfshira në këtë transaksion.
3. Autoriteti shqyrton kërkesën për bashkim ose ndarje dhe merr vendim pasi janë plotësuar kushtet dhe procedura e përcaktuar me rregullore të Autoritetit.
4. Autoriteti vendos për bashkimin e shoqërive të sigurimit vetëm pasi është marrë nga shoqëritë e sigurimit miratimi për bashkim nga Autoriteti i Konkurrencës.

Neni 55

Miratimi ose refuzimi i ndryshimeve

1. Shoqëritë e sigurimit, përpara se t'i dërgojnë asamblesë së jashtëzakonshme të aksionerëve çdo ndryshim të statutit të tyre, marrin miratimin e Autoritetit.
2. Autoriteti shprehet me shkrim për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve në statut brenda dy muajve nga data e depozitimit të ndryshimeve të projektstatutit. Në rast refuzimi, Autoriteti njofton me shkrim shoqërinë.
3. Shoqëria e sigurimit merr miratim nga Autoriteti përpara çdo ndryshimi të emrit të shoqërisë së sigurimit, duke argumentuar ndryshimin e kërkuar, ndryshimin e anëtarëve të drejtorisë, të ekspertit kontabël dhe të anëtarëve të komitetit të kontrollit të brendshëm.
4. Autoriteti brenda një periudhe njëmuajore, miraton ose refuzon kërkesën e shoqërisë së sigurimit për ndryshimet e kërkuara.
5. Dega e shoqërisë së huaj depoziton në Autoritet çdo ndryshim që i përket statutit të shoqërisë së huaj të sigurimit, degë e së cilës ajo është, brenda tre muajve nga data e ndryshimit.
6. Dega e shoqërisë së huaj depoziton në Autoritet dhe në gjykatë çdo ndryshim të emrit të shoqërisë së huaj, degë e së cilës ajo është, brenda një muaji nga data e ndryshimit në vendin e origjinës.

Neni 56

Kërkesa për pjesëmarrje influencuese

1. Zotërimi i aksioneve në një shoqëri siguri, ku një aksioner drejtpërsëdrejti ose jo drejtpërsëdrejti arrin ose tejkalon nivelin e pjesëmarrjes influencuese (aksioner influencues), të parashikuar në pikën 1 të nenit 16 të këtij ligji, bëhet vetëm me miratim të Autoritetit pas paraqitjes së kërkesës për pjesëmarrje influencuese.
2. Autoriteti përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, miraton edhe çdo pjesëmarrje të mëtejshme që arrin ose tejkalon 20 për qind, 33 për qind ose 50 për qind të të drejtave të votës ose pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë së sigurimit.
3. Aksioneri, i cili ka marrë miratimin e parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni njofton Autoritetin edhe për zvogëlimin e pjesëmarrjes së tij.
4. Nëse shoqëria është bërë subjekt i njëjës nga masat e parashikuara në nenin 127 të këtij ligji, operacioni i shitjes kryhet vetëm me autorizim të Autoritetit.
5. Çdo person fizik ose juridik, që kërkon të blejë drejtpërsëdrejti ose jo aksione në një shoqëri siguri, i nënshtrohet kërkesave të nenit 18 të këtij ligji.
6. Autoriteti përcakton me rregullore të tij dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e vendimit, të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, afatet e shqyrtimit dhe mënyrën e njoftimit,

të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

Neni 57

Miratimi, refuzimi dhe revokimi për pjesëmarrjen influencuese

1. Autoriteti merr vendim brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesave për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese.

2. Autoriteti miraton pjesëmarrjen influencuese nëse janë plotësuar kërkesat e parashikuara në rregulloren e hartuar për këtë qëllim duke përfshirë edhe kërkesat e përshtatshmërisë ligjore dhe teknike të pjesëmarrjes influencuese. *

3. Autoriteti refuzon kërkesën nëse nuk plotësohen kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi.

4. Autoriteti revokon miratimin e parashikuar në pikën 1 të nenit 56 të këtij ligji në rast se:

- a) është dhënë mbi bazën e informacionit të pasaktë ose të rremë;
- b) rrezikon veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit, sipas dispozitave të parashikuara në kreun VI të këtij ligji;
- c) aksioneri influencues i miratuar më parë nuk zotëron më 10 për qind të aksioneve me të drejtë vote në shoqërinë e sigurimit.

Neni 58

Miratimi ose refuzimi i investimeve të kapitalit të shoqërisë së sigurimit

1. Shoqëria e sigurimit nuk lejohet të investojë shuma më të mëdha se 10 për qind të kapitalit të saj në një ose disa persona juridikë jobankarë, pa marrë më parë miratimin e Autoritetit.

2. Shoqëria e sigurimit, në rast se kërkon të investojë shuma më të mëdha se 10 për qind të kapitalit të saj në një ose disa persona juridikë jobankarë, bën kërkesë me shkrim në Autoritet.

Autoriteti merr vendim në lidhje me parashikimet e bëra në pikën 2 të këtij neni, brenda tre muajve nga data e plotësimit të kërkesave të përcaktuara në rregulloren e tij.

SEKSIONI III NJOFTIMET

Neni 59

Njoftimi për zgjerimin ose kufizimin e veprimtarisë

Shoqëria e sigurimit ka të drejtë të zgjerojë ose të kufizojë numrin e degëve në territorin e Republikës së Shqipërisë, pasi ka njoftuar më parë Autoritetin.

SEKSIONI IV PUBLIKIMI

Neni 60

Publikimet e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

Autoriteti publikon në buletin e tij çdo vendim të parashikuar në dispozitat e këtij kreu.

KREU IV ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHOQËRISË SË SIGURIMIT DHE

KONTROLI I BRENDSHËM

Neni 61

Organet e shoqërisë së sigurimit

1. Shoqëria e sigurimit organizohet si shoqëri anonime, sipas ligjit “Për shoqëritë tregtare”, përveç rasteve kur është parashikuar shprehimisht ndryshe në këtë ligj.
2. Organet e shoqërisë së sigurimit janë:
 - a) asambleja e aksionerëve;
 - b) këshilli mbikëqyrës;
 - c) drejtoria.

Neni 62

Kushtet për të ushtruar funksionin e anëtarit të këshillit mbikëqyrës dhe të anëtarit të drejtorisë

1. Kushtet për të ushtruar funksionin e anëtarit të këshillit mbikëqyrës janë:
 - a) shfuqëzohet *
 - b) të ketë mbaruar studimet universitare;
 - c) të ketë kualifikime profesionale;
 - ç) të ketë dëshmi penaliteti;
 - d) të mos ketë pengesa ligjore për ushtrimin e këtij funksioni;
2. Kompetencat e këshillit mbikëqyrës përcaktohen në statutin e shoqërisë së sigurimit.
3. Kompetencat e drejtorisë përcaktohen në statutin e shoqërisë së sigurimit.
4. Kushtet për të ushtruar funksionin e anëtarit të drejtorisë janë ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Anëtarët e drejtorisë kërkohet të kenë përvojë jo më pak se tre vjet në drejtimin e shoqërive të sigurimit ose jo më pak se katër vjet në drejtimin e një shoqërie me aktivitet të ngjashëm ose jo më pak se katër vjet në drejtimin e institucioneve të tjera financiare.

Neni 63

Miratimi për ushtrimin e funksionit të anëtarit të këshillit mbikëqyrës dhe të anëtarit të drejtorisë

1. Në funksionin e anëtarit të këshillit mbikëqyrës dhe në funksionin e anëtarit të drejtorisë të një shoqërie sigurimi emërohet ai person, i cili ka marrë më parë miratimin e Autoritetit.
2. Kërkesa për ushtrimin e funksioneve, sipas pikës 1 të këtij neni, shoqërohet me dokumente që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 62 të këtij ligji.
3. Autoriteti merr vendim brenda 15 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes nga shoqëria e sigurimit të dokumentacionit të plotë.

Neni 64

Papajtueshmëria me funksionin e anëtarit të drejtorisë

- Një person nuk ushtron funksionin e anëtarit të drejtorisë nëse:
- a) është anëtar i drejtorisë së një shoqërie tjetër sigurimi apo dege të shoqërisë së huaj me seli në Republikën e Shqipërisë, përveç rasteve kur shoqëria e sigurimit është person juridik i lidhur me të;
 - b) shfuqëzohet *
 - c) i është hequr me ligj e drejta për të qenë në drejtorinë e një shoqërie tregtare të organizuar, sipas ligjit për shoqëritë tregtare;

ç) shërben ose ka shërbyer në çdo kohë për një periudhë 12-mujore paraardhëse si anëtar i organeve drejtuese dhe kontrolluese të një shoqërie tregtare që ka qenë objekt i procedurave të falimentimit;

d) ka shërbyer ose ka ndihmuar në themelimin e veprimtarive të paautorizuara tregtare të pranimit dhe të grumbullimit të depozitave;

dh) ka shërbyer ose ka ndihmuar në ushtrimin e veprimtarive të paautorizuara të sigurimit dhe të ndërmjetësimin;

e) ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paafëtisë paguese të detyrimeve ndaj të tretëve;

ë) ushtron detyrën e anëtarit të komitetit të kontrollit të brendshëm.

Neni 65

Përgjegjësitë e drejtorisë

Drejtoria e shoqërisë së sigurimit është përgjegjëse për:

a) zbatimin e legjislacionit në fuqi;

b) zbatimin e vendimeve të asamblesë së aksionerëve dhe të këshillit mbikëqyrës;

c) mbarëvajtjen e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit;

ç) hartimin dhe zbatimin e politikave, procedurave dhe praktikave që ndjek shoqëria e sigurimit dhe për kontrollin e brendshëm të veprimtarive të saj;

d) raportimin menjëherë në këshillin mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit dhe në Autoritet në rastet kur:

i) rrezikohet aftësia paguese dhe likuiditeti e saj;

ii) zgjerimi i veprimtarisë së shoqërisë rrezikon gjendjen financiare dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese.

Neni 66

Aktuari i autorizuar

1. Detyra e aktuarit në një shoqëri sigurimi kryhet vetëm nga aktuari i autorizuar nga Autoriteti.

2. Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj është e detyruar të emërojë aktuar të autorizuar dhe të njoftojë Autoritetin në lidhje me të.

3. Kriteret dhe kushtet për dhënien dhe tërheqjen e autorizimit të aktuarit, si dhe detyrat përcaktohen me rregullore të Autoritetit.

4. Autoriteti informon shoqëritë e sigurimit për personat, të cilët janë pajisur me autorizim për të kryer funksionin e aktuarit të autorizuar.

5. Autoriteti informon shoqëritë e sigurimit për personat, të cilëve u është tërhequr autorizimi për të kryer funksionin e aktuarit të autorizuar.

6. Nëse shoqëria e sigurimit nuk emëron një aktuar të autorizuar brenda 3 muajve nga data e mbetjes së vendit bosh, ose emëron një person të paautorizuar, emërimi i aktuarit të autorizuar bëhet nga Autoriteti.

Neni 67

Konflikti i interesave

Aktuari i autorizuar nuk lejohet të ushtrojë detyrën e tij në një shoqëri sigurimi apo degë të shoqërisë së huaj kur:

a) është drejtpërsëdrejti ose jo aksioner i shoqërisë së sigurimit;

b) është anëtar i këshillit mbikëqyrës ose i drejtorisë së shoqërisë së sigurimit;

c) është anëtar i komitetit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë së sigurimit.

Neni 68

Komiteti i kontrollit të brendshëm

1. Komiteti i kontrollit të brendshëm është njësi organizative e shoqërisë së sigurimit. Kjo njësi funksionon e ndarë nga njësitë e tjera të strukturës organizative të shoqërive të sigurimit.
2. Komiteti i kontrollit të brendshëm është organ që varet nga këshilli mbikëqyrës dhe raporton përpara tij.
3. Këshilli mbikëqyrës përcakton rregullat e funksionimit dhe të ushtrimit të kontrollit të brendshëm, si dhe miraton programin vjetor të kontrollit.
4. Anëtarë të komitetit të kontrollit të brendshëm nuk lejohet të ushtrorë asnjë funksion tjetër në shoqërinë e sigurimit.

Neni 69

Përgjegjësitë e komitetit të kontrollit të brendshëm

1. Komiteti i kontrollit të brendshëm kryen një kontroll të plotë mbi veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit dhe verifikon nëse shoqëria:
 - a) ushtron veprimtari në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;
 - b) mban në mënyrë të rregullt regjistrat e veprimtarisë ekonomike;
 - c) pasqyron saktë të dhënat në dokumentacionin e kontabilitetit;
 - ç) përgatit raportet vjetore financiare dhe statistikore.
2. Komiteti i kontrollit të brendshëm ushtron detyrën e tij në përputhje me:
 - a) parimet profesionale dhe standardet e kontrollit të brendshëm;
 - b) kodin e etikës profesionale;
 - c) rregullat e funksionimit dhe të ushtrimit të kontrollit, të përcaktuara nga këshilli mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit.

Neni 70

Raportet e komitetit të kontrollit të brendshëm

1. Komiteti i kontrollit të brendshëm përgatit jo më pak se dy herë në vit një raport kontrolli, i cili përmban:
 - a) përshkrimin e kontrolleve të ushtruara mbi veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit;
 - b) efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
 - c) parregullsitë e konstatuara nga ushtrimi i kontrollit të brendshëm dhe masat e propozuara për eliminimin e tyre;
 - ç) zbatimin e masave të vendosura më parë nga këshilli mbikëqyrës.
2. Komiteti i kontrollit të brendshëm përgatit një raport vjetor, që përmban të dhëna për realizimin e programit të veprimtarisë së tij.
3. Raportet i paraqiten drejtorisë dhe këshillit mbikëqyrës dhe më pas raporti vjetor i miratuar i paraqitet Autoritetit, për t'u shprehur në lidhje me të.
4. Nëse gjatë ushtrimit të kontrollit, komiteti i kontrollit të brendshëm konstaton që shoqëria e sigurimit ka shkelur rregullat e menaxhimit të rrezikut dhe si pasojë rrezikohet aftësia paguese e saj, likuiditeti ose vazhdimësia e veprimtarisë, informon menjëherë drejtorinë dhe këshillin mbikëqyrës.

Neni 71

Eksperti kontabël

1. Shoqëria e sigurimit apo dega e shoqërisë së huaj emëron si ekspertë kontabël të autorizuar vetëm personat juridikë të miratuar nga Autoriteti.

2. Eksperti kontabël i autorizuar i shoqërisë së sigurimit apo degës së shoqërisë së huaj është shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar.

3. Shoqëria e sigurimit apo dega e shoqërisë së huaj është e detyruar të marrë miratimin e Autoritetit, për çdo ndryshim të ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë.

Neni 72

Raporti i shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar

1. Raporti vjetor financiar i shoqërisë së sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj i nënshtrohet kontrollit dhe vërtetimit ligjor nga shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar, e cila jep opinionin e saj.

2. Autoriteti mund të përcaktojë standarde analitike të raportimit dhe të kontabilitetit, të detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit.

3. Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj paraqet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare një kopje të raportit vjetor të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar brenda 8 ditëve nga data e marrjes, por jo më vonë se data 30 prill e vitit pasardhës. Nëse shoqëria e sigurimit përgatit llogari të konsoliduara ose zotëron pjesëmarrje në shoqëri të tjera, ky raport paraqitet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare jo më vonë se data 31 maj e vitit pasardhës. * *

Neni 73

Përmbajtja e raportit

1. Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar kontrollon dhe vërteton ligjërisht, nëpërmjet një raporti, sipas standardeve dhe procedurave profesionale, lidhur me paraqitjen e vërtetë dhe ligjore të:

a) bilancit të shoqërisë së sigurimit apo degës së shoqërisë së huaj;

b) llogarisë fitime-humbje;

c) pasqyrës së provigjoneve teknike ose provigjoneve matematike, sipas llojit dhe klasave të sigurimit dhe drejtimet e investimeve të tyre mbi bazën e llogaritjeve aktuariale;

ç) listës së asetëve në mbulim të provigjoneve teknike ose provigjoneve matematike dhe strukturën e investimeve të tyre;

d) veprimtarisë së kontrollit të brendshëm;

dh) mbajtjes së regjistrave kontabël;

e) vlerësimit të zërave të bilancit dhe atyre jashtë bilancit;

ë) shpërndarjes së fitimit;

f) pasqyrës së qarkullimit të mjeteve monetare.

2. Autoriteti ka të drejtë t'i kthejë raportin shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar nëse nuk është përgatitur në përputhje me pikën 1 të këtij neni, dhe ka të drejtë të caktojë një shoqëri tjetër të ekspertëve kontabël të autorizuar me shpenzimet e shoqërisë së sigurimit apo degës së shoqërisë së huaj për të hartuar një raport në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Neni 74

Raportimi në Autoritet

1. Nëse shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar gjatë ushtrimit të kontrollit, konstaton që shoqëria e sigurimit apo dega e shoqërisë së huaj ka shkelur rregullat e menaxhimit të rrezikut dhe si pasojë rrezikohet aftësia paguese, likuiditeti, ose vazhdimësia e veprimtarisë së

shoqërisë së sigurimit apo degës së shoqërisë së huaj, informon menjëherë Autoritetin.

2. Autoriteti ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë së sigurimit apo degës së shoqërisë së huaj çdo informacion mbi veprimtarinë e saj. Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar është e çliruar nga sekreti profesional në dhënien e informacionit për Autoritetin.

Neni 75

Publikimi i raportit vjetor

1. Shoqëria e sigurimit apo dega e shoqërisë së huaj publikon në një nga botimet periodike financiare raportin vjetor të saj brenda 15 ditëve nga data e miratimit të raportit vjetor nga Autoriteti, por jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.

2. Raporti vjetor përfshin bilancin vjetor, llogarinë fitim-humbje dhe raportin përmbledhës të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar.

KREU V

NDËRMJETËSIMI NË SIGURIM DHE RISIGURIM

Neni 76

Veprimtaria e ndërmjetësimit

1. Veprimtaria e ndërmjetësimit ushtrohet nga agjentët ose shoqëri agjentësh dhe nga shoqëritë e brokerimit.

2. Për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në Republikën e Shqipërisë, agjenti dhe brokeri pajisen me licencë nga Autoriteti.

3. Veprimtaria e brokerit është e papajtueshme me veprimtarinë e agjentit.

Neni 77

Agjenti dhe shoqëria e agjentëve

1. Agjenti është një person fizik i licencuar nga Autoriteti, i cili vepron në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit apo degës së shoqërisë së huaj.

2. Shoqëria e agjentëve krijohet si shoqëri anonime me seli në Republikën e Shqipërisë, e licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në sigurime.

3. Agjenti ose shoqëria e agjentëve e licencuar ushtron veprimtari vetëm në emër të një shoqërie sigurimi apo degës së shoqërisë së huaj, me përjashtim kur në kontratën midis agjentit ose shoqërisë së agjentëve dhe shoqërisë së sigurimit apo degës së shoqërisë së huaj, parashikohet ndryshe.

4. Agjenti nuk ka të drejtë të autorizojë asnjë person tjetër që të nënshkruajë kontratën e sigurimit në emër dhe për llogari të tij.

5. Në shoqërinë e agjentëve funksionet e agjentit ushtrohen në emër të shoqërisë së agjentëve nga persona fizikë, ortakë ose aksionerë që janë agjentë të licencuar nga Autoriteti.

6. Agjenti apo shoqëria e agjentëve nuk lejohet të ushtrojnë njëkohësisht veprimtari ndërmjetësimi në sigurimin e jetës dhe të jo-jetës.

7. Shoqëria e agjentëve depoziton në Autoritet vendimin e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, së bashku me aktin e themelimit dhe statutin e saj.

8. Marrëdhëniet midis agjentit të licencuar ose shoqërisë së agjentëve dhe shoqërisë së sigurimit ose degës së shoqërisë së huaj janë të përcaktuara në kontratën e lidhur ndërmjet tyre.

9. Veprimtarinë e agjentit në sigurime mund ta ushtrojnë edhe ente të tjera që kryejnë veprimtari në fushën e shërbimeve, me kusht që të punësojnë agjentë të licencuar nga Autoriteti.

10. Fusha e shërbimeve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 78

Brokeri

Brokeri është një person fizik i autorizuar nga Autoriteti, i cili ushtron veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime në emër të shoqërisë së brokerimit.

Neni 79

Shoqëria e brokerimit

1. Shoqëria e brokerimit themelohet si shoqëri anonime me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë, e licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime me kapital minimal 5 milionë lekë.

2. Shoqëria e brokerimit e licencuar ushtron veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime në emër dhe për llogari të të siguruarit.

3. Pavarësisht nga pika 2 e këtij neni, veprimtarinë e shoqërisë së brokerimit në sigurime mund ta ushtrojnë edhe bankat, pasi të kenë marrë më parë miratim nga Banka e Shqipërisë dhe të jenë licencuar nga Autoriteti.

4. Shoqëria e brokerimit depoziton në Autoritet vendimin e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar së bashku me aktin e themelimit dhe statutin e saj.

5. Në shoqërinë e brokerimit, funksionet e brokerit ushtrohen në emër të shoqërisë të brokerimit nga persona fizikë, ortakë ose aksionerë që janë broker të autorizuar nga Autoriteti.

6. Shoqëria e brokerimit paguhet me komision nga shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj, sipas kontratave të sigurimit të shitura për llogari të saj, përveçse, kur me marrëveshje të lidhur midis shoqërisë së brokerimit dhe të siguruarit është parashikuar ndryshe.

Neni 80

Garancia financiare dhe sigurimi i përgjegjësive

1. Shoqëria e brokerimit duhet të zotërojë një garanci financiare të barabartë me kufirin e kapitalit minimal, të parashikuar në pikën 1 të nenit 79 të këtij ligji.

2. Shoqëria e brokerimit, përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, siguron në një shoqëri sigurimi përgjegjësitë profesionale të saj ndaj palëve të treta për mbulimin e përgjegjësisive, për rastet e shkeljes së kushteve të kontratës së ndërmjetësimit, në një shumë jo më të vogël se 30 milionë lekë për një rast sigurimi ose jo më të vogël se 100 milionë lekë për të gjitha rastet e sigurimit në një vit kalendarik.

Neni 81

Licencimi i ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime

1. Autoriteti licencon ndërmjetësit në qoftë se plotësojnë:

a) kriteret e besueshmërisë;

b) kriteret e aftësisë profesionale.

2. Kriteret, procedura, afati i vlefshmërisë së licencës, rastet e refuzimit të saj, si dhe

rregullat e mbikëqyrjes së ndërmjetësve caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit është e patransferueshme dhe e patregtueshme. Ajo jepet për një afat të përcaktuar në kohë, përjashtuar shoqëritë e brokerimit.

Neni 82

Përgjegjësitë e agjentit dhe të shoqërisë së sigurimit

1. Në qoftë se i siguruari përfundon një kontratë sigurimi nëpërmjet agjentit apo shoqërisë së agjentëve, shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj, në emër të së cilës vepron agjenti ose shoqëria e agjentëve, është përgjegjëse e vetme për veprimet ose mosveprimet e agjentit apo të shoqërisë së agjentëve në lidhje me të siguararin.

2. Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj lidh kontratë ndërmjetësimi vetëm me agjentë apo shoqëri agjentësh të licencuar, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe të këtij ligji.

3. Agjenti apo shoqëria e agjentëve është përgjegjëse ndaj shoqërisë së sigurimit për humbjet e shkaktuara të siguararit, si rezultat i neglizhencës ose i keqinformimit të tij.

Neni 83

Përgjegjësitë e shoqërisë së brokerimit

1. Shoqëria e brokerimit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, përfaqëson interesat e të siguararve. Përpara lidhjes së kontratës shoqëria e brokerimit i jep të siguararit shpjegime dhe këshilla lidhur me kushtet, afatet, kufizimet apo përjashtimet e kontratës dhe primit të sigurimit ose risigurimit.

2. Shoqëria e brokerimit njofton shoqërinë e sigurimit ose degën e shoqërisë së huaj për propozimet e të siguararit në lidhje me hyrjen në fuqi të kontratës së sigurimit ose risigurimit. Ai i paraqet të siguararit kushtet e kontratës së sigurimit dhe rregullat e përcaktimit të primit.

3. Shoqëria e brokerimit duhet të kontrollojë përmbajtjen e kontratës së sigurimit përpara lidhjes së saj.

4. Shoqëria e brokerimit paguan brenda 30 ditëve kalendrike primet e grumbulluara nga të siguararit pranë shoqërisë së sigurimit. Primet e arkëtuara nga shoqëria e brokerimit, por akoma të papaguara shoqërisë së sigurimit, depozitohen në një llogari qëllimore në një bankë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Shoqëria e brokerimit është përgjegjëse ndaj të siguararve për humbjet që pësojnë ata, kur këto shkaktohen nga neglizhenca ose keqinformimi i të siguararit.

6. Shoqëria e brokerimit i bën të ditur të siguararit të gjitha marrëdhëniet juridike dhe ekonomike me një shoqëri të caktuar sigurimi ose degë të shoqërisë së huaj, të cilat ndikojnë në paanshmërinë e shoqërisë së brokerimit, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kundrejt të siguararve.

7. Marrëdhëniet juridike dhe ekonomike, në kuptim të pikës 6 të këtij neni, konsiderohen marrëveshjet e shoqërisë së brokerimit të përfunduara me një shoqëri sigurimi ose degë të shoqërisë së huaj, në bazë të të cilave një shoqëri brokerimi ka të drejtën e një komisioni brokerimi të veçantë ose më të lartë për klasa ose shoqëri të caktuara sigurimi.

Neni 84

Detyrimi i shoqërisë së brokerimit dhe i shoqërisë së sigurimit

1. Shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit ose risigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Shoqëria e brokerimit nuk lejohet të ndërmjetësojë në lidhjen e kontratave të sigurimit ose risigurimit, të cilat janë në kundërshtim me nenin 157 të këtij ligji.

3. Shoqëria e brokerimit nuk mund të jetë aksioner i një shoqërie sigurimi dhe anasjelltas.
4. Shoqëria e sigurimit lidh kontratë për kryerjen e veprimtarisë së ndërmjetësimit vetëm me shoqëri brokerimi të licencuara nga Autoriteti, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 85

Tërheqja e licencës

1. Autoriteti tërheq licencën për ushtrim veprimtarie ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime në rastet kur:

- a) ndërmjetësi nuk fillon veprimtarinë e ndërmjetësimit brenda 6 muajve nga data e marrjes së licencës;
- b) ndërmjetësi vullnetarisht heq dorë nga ushtrimi i veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime;
- c) vërtetohet se dokumentet për dhënien e licencës janë të falsifikuara ose të rreme;
- ç) ndërmjetësi e ushtron veprimtarinë e tij në kundërshtim me interesat e të siguruarve;
- d) ndërmjetësi ka shkelur dispozitat e këtij ligji;
- dh) ndërmjetësi qëllimisht ka ofruar informacion të rremë për të siguruarit ose për “Autoritetin”;
- e) ndërmjetësi kryen veprime mashtruese me veprimtarinë e tij.

2. Vendimi i Autoritetit për tërheqjen e licencës botohet në dy gazeta me qarkullim kombëtar brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

3. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj detyrohen të zgjidhin kontratën e ndërmjetësimit, në rast së ndërmjetësit i është tërhequr licenca, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni.

Neni 86

Ankimi

Vendimi i Autoritetit për tërheqjen e licencës së ndërmjetësit ankimohet në përputhje me parashikimet e dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 87

Shoqëria e huaj e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime

1. Shoqëria e huaj e ndërmjetësimit ushtron veprimtari ndërmjetësimi në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm nëpërmjet degës së licencuar nga Autoriteti.

2. Dispozitat e neneve të këtij kreu janë të zbatueshme edhe për degën e shoqërisë së huaj të ndërmjetësimit, e cila ushtron veprimtari ndërmjetësimi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 88

Regjistri i ndërmjetësve

1. Shoqëria e sigurimit detyrohet të mbajë regjistër të agentëve dhe shoqërive të agentëve, me të cilët ka lidhur kontratë ndërmjetësimi.

2. Shoqëria e sigurimit njofton menjëherë Autoritetin kur lidh ose zgjidh një kontratë me një agjent apo shoqëri agjentësh.

3. Shoqëria e brokerimit mban regjistër të brokerave të punësuar prej saj.

4. Shoqëria e brokerimit mban regjistrin e shoqërive të sigurimit, me të cilat ka lidhur marrëveshje.

5. Shoqëritë e brokerimit depozitojnë në Autoritet marrëveshjet e lidhura me shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit.

6. Autoriteti mban regjistrin e agentëve, të shoqërive të agentëve, të shoqërive të

brokerimit dhe të degëve të shoqërive të huaja të ndërmjetësimit të licencuara prej tij.

Neni 89

Licencimi i vlerësuesve të dëmeve dhe konsulentëve në sigurime

1. Autoriteti licencon vlerësuesit e dëmeve, mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e tyre.
2. Kriteret dhe kushtet për dhënien dhe tërheqjen e licencës së vlerësuesve të dëmeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Autoriteti licencon konsulentët në sigurime, mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e tyre. Kriteret dhe kushtet, procedurat dhe afati i vlefshmërisë së dhënies të licencës, si dhe rastet e tërheqjes së licencës së konsulentëve në sigurime përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Autoriteti mban regjistrin e vlerësuesve të dëmeve dhe të konsulentëve në sigurime, të licencuar prej tij, si dhe njofton shoqëritë e sigurimit ose degën e shoqërisë së huaj për personat që kanë marrë licencën.
5. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj detyrohen të bëjnë vlerësimin e dëmeve me vlerësues dëmsh të licencuar.
6. Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj pranon konsulencë nga konsulentë të licencuar.
7. Autoriteti informon shoqëritë e sigurimit dhe degën e shoqërisë së huaj për personat, të cilëve u është tërhequr licenca për të ushtruar veprimtarinë e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të këtij neni.
8. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj detyrohen të zgjidhin kontratën me vlerësuesit e dëmeve dhe konsulentët në sigurime në rast se u është tërhequr licenca.
9. Vendimi i Autoritetit për tërheqjen e licencës së vlerësuesve të dëmeve dhe konsulentëve në sigurime ankimohet në përputhje me parashikimet e bëra në Kodin e Procedurave Administrative.

KREU VI

MENAXHIMI I RREZIKUT

SEKSIONI I

KAPITALI I SHOQËRISË SË SIGURIMIT

Neni 90

Kapitali i shoqërisë së sigurimit

Kapitali i shoqërisë së sigurimit përbëhet nga kapitali themeltar dhe kapitali shtesë.

Neni 91

Kapitali themeltar

1. Në llogaritjen e kapitalit themeltar të një shoqërie sigurimi përfshihen elementet e mëposhtme:
 - a) kapitali aksioner i paguar;

b) rezerva e sigurisë, që nuk i përket drejtpërsëdrejti kontratave të sigurimit në fuqi ose atyre që kanë qenë në fuqi;

c) provigjonet e shoqërisë së sigurimit (statutore dhe të specifikuar në statut), që nuk i përketin drejtpërsëdrejti kontratave të sigurimit në fuqi ose atyre që kanë qenë në fuqi;

ç) fitimi i pashpërndarë i trashëguar nga vitet e mëparshme;

d) fitimi i pashpërndarë që i përket vitit ushtrimor, pasi i janë zbritur taksat, kontributet e tjera dhe dividendet e paguara, pasi shuma e fitimit është verifikuar nga eksperti kontabël i autorizuar i shoqërisë së sigurimit.

dh) humbjet e vitit ushtrimor dhe humbjet e trashëguara dhe të prapambetura.

2. Në llogaritjen e kapitalit themeltar të një veprimtarie nuk do të përfshihen elementet e mëposhtme:

a) aksione të shoqërisë së sigurimit të paguara;

b) aktivet e patrupëzuara;

c) humbjet e vitit ushtrimor dhe humbjet e trashëguara dhe të pambuluara;

ç) angazhime të tjera që shoqëria e sigurimit është e detyruar të pasqyrojë në bilancin financiar (angazhime jashtë bilancit).

3. Kapitali themeltar i një shoqërie sigurimi në mjete monetare, pa përfshirë kontributin në natyrë, është në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 17 të këtij ligji.

Neni 92

Kapitali shtesë

1. Në llogaritjen e kapitalit shtesë të një shoqërie sigurimi përfshihen elementet e mëposhtme:

a) kapitali aksioner i paguar mbi bazën e aksioneve preferenciale të akumuluar;

b) instrumentet e borxhit të varur;

c) letra me vlerë me maturim të pakufizuar.

2. Instrumentet e borxhit të varur janë letra me vlerë dhe instrumente të tjera financiare, të cilat, në rast falimentimi ose likuidimi të emetuesit, janë:

a) të ripagueshme vetëm pasi janë shlyer borxhet e tjera të emetuesit;

b) të përshtatshme për mbulimin e humbjeve të mundshme, për të cilat shoqëria e sigurimit është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndodhura, karakteristikat e të cilave kanë lidhje me maturimin e tyre.

Neni 93

Rezerva e sigurisë

1. Shoqëria e sigurimit krijon dhe mban çdo vit financiar me burimet e veta rezervën e sigurisë në nivelin jo më pak se 1/3 e fitimit të vitit ushtrimor, nëse fitimi nuk përdoret për mbulimin e humbjeve të trashëguara nga vitet e mëparshme.

2. Shoqëria e sigurimit, që ka akumuluar rezervën e sigurisë në një nivel jo më të ulët se 30 për qind të primeve mesatare të grumbulluara në dy vitet e fundit, kur primet e viteve të mëparshme janë rritur si rezultat i rritjes së indeksit të çmimeve, duke përfshirë edhe vitin për të cilin fitimi është shpërndarë, nuk ka detyrimin të krijojë nga fitimi rezervën e sigurisë.

3. Rezervat e sigurisë janë aktivet që shërbejnë për të mbuluar përgjegjësitë afatgjata të shoqërisë së sigurimit. Ato janë akumulative dhe nuk tejkalojnë 30 për qind të totalit të primeve të shkruara neto mesatare vjetore në dy vitet e fundit, por jo më pak se 15 për qind e primeve të shkruara bruto mesatare vjetore në dy vitet e fundit. Kjo rezervë krijohet për të garantuar aftësinë paguese dhe fondin e garancisë së shoqërisë së sigurimit.

Neni 94
Llogaritja e kapitalit

Kapitali i shoqërisë së sigurimit referuar neneve 91, 92 dhe 93 të këtij ligji, llogaritet pasi zbriten elementet e mëposhtme:

a) investimet e shoqërisë së sigurimit në aksione dhe instrumente të borxhit të varur, të emetuara nga një shoqëri tjetër sigurimi ose ente të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind;

b) investime të tjera në entet e parashikuara në shkronjën “a” të këtij neni, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të enteve respektive;

c) investimet e shoqërisë së sigurimit në aksione ose instrumente të borxhit të varur, emtuar nga një shoqëri tjetër sigurimi ose nga ente financiare, të tjera nga ato të parashikuara në shkronjën “a” të këtij neni, që tejkalon 10 për qind të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, të llogaritur përpara zbritjes së elementeve të shkronjës “a” dhe “b” të këtij neni.

ç) aktivet jolikuide të shoqërisë së sigurimit. Në këto aktive përfshihen:

i) investimet në bursë të shoqërisë;

ii) detyrime që rrjedhin për pagesat, që i përkasin fondit të garancisë dhe enteve shtetërore;

iii) detyrime të tjera, të cilat nuk mund të kthehen në likuiditet brenda periudhës që nevojitet për të shlyer detyrimet e shoqërisë.

Neni 95
Investimi i kapitalit

1. Shoqëria e sigurimit investon kapitalin e saj në drejtimet e mëposhtme:

a) pasuri të paluajtshme (toka dhe ndërtesa);

b) investime financiare (letra me vlerë të Qeverisë dhe të borxhit publik, letra borxhi, mjete të tjera të tregjeve të parasë dhe kapitalit).

2. Kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërisë së sigurimit përcaktohen me rregullore të Autoritetit.

3. Investimet financiare të shoqërisë së sigurimit në një bankë, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, nuk lejohet të tejkalojnë 25 për qind të kapitalit të shoqërisë.

4. Investimet financiare të shoqërisë së sigurimit në një person juridik jobankar, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, nuk lejohet të tejkalojnë 10 për qind të kapitalit të shoqërisë.

Neni 96
Aftësia paguese

1. Shoqëria e sigurimit, gjatë gjithë veprimtarisë së saj, duhet të zotërojë një kapital të mjaftueshëm, që përbën edhe aftësinë paguese të saj.

2. Aftësia paguese i përgjigjet vlerës së aktiveve të shoqërisë së sigurimit, të lirë nga çdo detyrim ose përgjegjësi e parashikuar.

3. Aftësia paguese e shoqërisë së sigurimit llogaritet në përputhje me nenet 91, 92, 93 dhe 94 të këtij ligji.

Neni 97
Niveli i kërkuar i aftësisë paguese

1. Kapitali i shoqërisë së sigurimit, që ushtron veprimtari sigurimi në klasat e jo-jetës, gjatë gjithë veprimtarisë së shoqërisë, nuk duhet të jetë më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese të shoqërisë, i llogaritur me metodën me bazë primet ose me bazë dëmet. Niveli i kërkuar është vlera më e madhe e përftuar nga llogaritjet.

2. Pavarësisht nga sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, vetëm për vitin e parë të veprimtarisë, niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritet duke zbatuar metodën me bazë primet.

3. Kapitali i shoqërisë së sigurimit, që ushtron veprimtari sigurimi në klasat e jetës, gjatë gjithë veprimtarisë së shoqërisë, nuk duhet të jetë më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese të shoqërisë, i llogaritur si shuma totale e rezultateve të përfuara nga medotat e përdorura.

4. Mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe të jo-jetës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 98

Fondi i garancisë

1. Fondi i garancisë së shoqërisë së sigurimit është i barabartë me 1/3 e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, fondi i garancisë së një shoqërie sigurimi, brenda klasave të sigurimit të jo jetës, nuk mund të jetë më i ulët se kufijtë minimalë të mëposhtëm:

a) 370 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 10, 11, 12, 13 e 15, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji;

b) 260 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 16 e 18, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji;

c) 185 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 9 e 17, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji;

ç) 615 milionë lekë, nëse shoqëria mbulon të gjitha ose disa prej rreziqeve të klasës 14, të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji, nëse totali i primeve vjetore, për këtë klasë, tejkalon shumën 35 milionë lekë ose 4 për qind të totalit të primeve vjetore të shoqërisë së sigurimit;

d) 370 milionë lekë, nëse shoqëria mbulon të gjitha ose disa prej rreziqeve të klasës 14, të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji, nëse totali i primeve vjetore, për këtë klasë, për secilin nga tri vitet e fundit të veprimtarisë, nuk tejkalon shumën 35 milionë lekë ose 4 për qind të totalit të primeve vjetore të shoqërisë së sigurimit.

3. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, fondi i garancisë së një shoqërie sigurimi, brenda klasave të sigurimit të jetës, nuk mund të jetë më i ulët se kufiri minimal prej 370 milionë lekësh, në fillim të veprimtarisë, nëse shoqëria ushtron veprimtari për sigurimin e jetës në klasat 19, 20, 21, 22 e 23, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji.

4. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, fondi i garancisë së një shoqërie risigurimi nuk mund të jetë më i ulët se 615 milionë lekë.

5. Kufiri minimal i fondit të garancisë së shoqërisë, që mbulon rreziqet e disa klasave të sigurimit të jo jetës, duhet të jetë i barabartë me vlerën e kufirit minimal të fondit të garancisë së klasës së sigurimeve, për të cilin është parashikuar kufiri më i lartë.

6. Fondi i garancisë depozitohet në një llogari bankare qëllimore, me të njëjtin emër, në njërin nga bankat, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, atje ku shoqëria ka selinë qendrore të saj.

7. Fondi i garancisë investohet vetëm brenda sistemit bankar në bono thesari dhe depozita, me afat maturimi jo më të vogël se 1 vit.

8. Administrimi dhe rastet e ndërhyrjes në fondin e garancisë së shoqërisë së sigurimit

përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”. * *

Neni 98/1

Për shoqëritë e sigurimit, të licencuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, fondi i garancisë, i parashikuar në nenin 98 të këtij ligji, do të jetë në nivelet e mëposhtme:

a) nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 10, 11, 12, 13 e 15, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji:

- i) 185 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;
- ii) 270 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;
- iii) 370 milionë lekë deri më 31 mars 2008;

b) nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 16 e 18, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji:

- i) 130 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;
- ii) 190 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;
- iii) 260 milionë lekë deri më 31 mars 2008;

c) nëse shoqëria ushtron veprimtari në klasat 9 e 17, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji:

- i) 90 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;
- ii) 135 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;
- iii) 185 milionë lekë deri më 31 mars 2008;

ç) nëse shoqëria mbulon të gjitha ose disa prej rreziqeve të klasës 14, të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji, nëse totali i primeve vjetore, për këtë klasë, tejkalon shumë 35 milionë lekë ose 4 për qind të totalit të primeve vjetore të shoqërisë së sigurimit:

- i) 370 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;
- ii) 500 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;
- iii) 615 milionë lekë deri më 31 mars 2008;

d) nëse shoqëria mbulon të gjitha ose disa prej rreziqeve të klasës 14, të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji, nëse totali i primeve vjetore, për këtë klasë, për secilin nga tri vitet e fundit të veprimtarisë, nuk tejkalon shumë 35 milionë lekë ose 4 për qind të totalit të primeve vjetore të shoqërisë së sigurimit:

- i) 185 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;
- ii) 270 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;
- iii) 370 milionë lekë deri më 31 mars 2008;

dh) nëse shoqëria ushtron veprimtari për sigurimin e jetës në klasat 19, 20, 21, 22 e 23, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji:

- i) 220 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;
- ii) 300 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;
- iii) 370 milionë lekë deri më 31 mars 2008;

e) nëse shoqëria ushtron veprimtarinë e risigurimit:

- i) 370 milionë lekë deri në një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;
- ii) 500 milionë lekë deri më 30 shtator 2007;
- iii) 615 milionë lekë deri më 31 mars 2008.”. * *

Neni 99

Primet e sigurimit ose të risigurimit

Primi i sigurimit ose i risigurimit përbëhet nga:

- a) pjesa e llogaritur për mbulimin e rrezikut të marrë në sigurim i quajtur primi i pastër;
- b) pjesa e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve administrative;
- c) elementet e kursimit për klasa të caktuara të sigurimit të jetës;;
- ç) pjesa e llogaritur për fitimin e shoqërisë, duke përfshirë fitimin nga investimi pa risk dhe investimi në sigurime me risk.

Neni 100

Miratimi i primeve

1. Primi i pastër për mbulimin e rrezikut të marrë në sigurimin e detyrueshëm miratohet nga Ministri i Financave.
2. Primet e sigurimit vullnetar përcaktohen nga vetë shoqëria e sigurimit.
3. Autoriteti, në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, kërkon bazat teknike të përdorura për llogaritjen e tarifave dhe primeve për të gjitha produktet e sigurimit vullnetar.
4. Autoriteti, për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e sigurimit të jetës, ka të drejtë të rekomandojë bazën e të dhënave statistikore që përdoren në llogaritjen e primit.
5. Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit në sigurime janë të detyruar të zbatojnë primet e sigurimit të detyrueshëm.

SEKSIONI II PROVIGJONET

Neni 101

Provigjonet teknike dhe matematike

1. Shoqëria e sigurimit, në përputhje me veprimtarinë që ushtron, krijon provigjone teknike dhe matematike të mjaftueshme për të përmbushur përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe të risigurimit.
2. Provigjonet teknike dhe matematike të shoqërisë së sigurimit krijohen përpara nxjerrjes së rezultatit financiar të vitit ushtrimor.
3. Shoqëria e sigurimit të jo-jetës është e detyruar të krijojë provigjonet e mëposhtme:
 - a) provigjone për primin e pafituar, të cilat krijohen për atë pjesë të primit të paguar, që i përket periudhës së rrezikut pas datës së mbylljes të vitit financiar.
 - b) provigjone për bonuse dhe rabate formohen deri në një shumë, që barazon pagesat që personat e siguruar kanë të drejtë të marrin dhe të cilat:
 - i) krijohen në një nivel të barabartë me shumën që të siguruarit marrin në bazë të të drejtave për një pjesë fitimi ose të drejta të tjera (bonuse), që rrjedhin nga kontrata e sigurimit;
 - ii) krijohen në një nivel të barabartë me të drejtën për reduktim pjesor në prime (rabate);
 - iii) krijohen në një nivel të barabartë me të drejtën e rimbursimit të pjesës së primit të lidhur me periudhën e papërdorur të sigurimit për shkak të anulimit të kontratës;
 - c) provigjoni për barazimin e dëmeve, i cili krijohet për ato pjesë të dëmeve që rezultojnë nga ngjarje të siguruara, të cilat kanë ndodhur përpara përfundimit të periudhës financiare, por tejkalojnë detyrimet e vlerësuara të shoqërisë. Provigjoni i barazimit të dëmeve shërben për barazimin e përkohshëm të luhatjeve të humbjeve të paparashikuara;
 - ç) provigjone të tjera teknike krijohen duke iu referuar detyrimeve të pritshme dhe rreziqeve për dëme të mëdha, për sigurimin e përgjegjësive nukleare, prodhimeve farmaceutike, tërmeteve, përmbytjeve, si dhe provigjone për detyrime ose rreziqe të tjera, që nuk përfshihen në asnjë nga provigjonet e parashikuara në këtë nen;
 - d) provigjonet matematike do të mbahen në vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme të

vlerësuar të shoqërisë së sigurimit, të cilat vijnë nga kontratat e sigurimit, pasi të jetë zbritur vlera aktuale e përcaktuar e primeve të ardhshme që janë për t'u paguar në bazë të një vlerësimi aktuarial të miratuar nga Autoriteti;

dh) provigjone për dëme të ndodhura, por ende të papaguara.

3. Provigjonet matematike llogariten si vlerësim aktuarial, duke marrë parasysh të gjitha detyrimet e ardhshme të shoqërisë së sigurimit, të cilat vijnë nga kontratat individuale të sigurimit, duke përfshirë edhe:

a) pagesat e garantuara, në të cilat personat e siguruar kanë të drejta;

b) bonuset, në të cilat personi i siguruar gëzon të drejtën individualisht ose së bashku me persona të tjerë të siguruar, pavarësisht nga forma e tyre;

c) të gjitha të drejtat, nga të cilat personi i siguruar lejohet të zgjedhë në bazë të kontratës së sigurimeve;

ç) detyrimet, përfshirë dhe komisionet.

4. Në zgjedhjen e metodës së vlerësimit aktuarial, duhet të merren në konsideratë metoda e vlerësimit të aseteve në mbulim të provigjoneve teknike që zbaton shoqëria e sigurimit.

5. Provigjonet matematike duhet të llogariten për çdo kontratë sigurimi në veçanti dhe nuk mund të jenë më të vogla se zero. Përafritmet e përshtatshme ose përgjithësimet mund të zbatohen vetëm kur dëshirohet që rezultati i arritur në kuptim të tyre do të jetë përafërsisht i njëjtë si ai i një llogaritjeje të veçantë.

6. Kur në bazë të kontratës personi i siguruar ka të drejtën e pagesës së vlerës së dorëzuar, provigjonet matematike, të formuara duke iu referuar kësaj kontrate sigurimi, nuk duhet të jenë nën vlerën e dorëzuar.

7. Shoqëria e sigurimit, që nënshkruan kontrata të sigurimit të jetës ose kontrata të sigurimit të jo-jetës, për të cilat zbatohen tabelat e probabilitetit dhe llogaritje të njëjta me ato të sigurimit të jetës, krijojnë provigjone matematike për këto kontrata.

8. Shoqëritë e sigurimit detyrohen që në shtojcën e raportit vjetor të japin shpjegime të bazave dhe metodave të aplikuara në llogaritjen e provigjoneve matematike.

9. Shoqëria e sigurimit që nënshkruan kontrata sigurimi, në të cilat rreziku i investimit mbahet nga personi i siguruar, krijon provigjone për këtë qëllim.

10. Bazat dhe metodat e llogaritjes, si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike dhe matematike përcaktohen me rregullore të Autoritetit.

SEKSIONI III

AKTIVET NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE

Neni 102

Aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike

1. Aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike janë aktivitet e shoqërisë së sigurimit, të cilat shërbejnë për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit ose të risigurimit.

2. Aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike janë të barabarta me përgjegjësitë financiare të kontraktuara për sa i përket shumës dhe monedhës përkatëse.

3. Aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike për përgjegjësitë e kontraktuara në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të gjenden në Republikën e Shqipërisë.

4. Autoriteti ka të drejtë të autorizojë vendosjen e këtyre aktiveve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur ato janë të mbështetura ligjërisht.

5. Aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, që gjenden në formën e kërkesave debitore, konsiderohen të vendosura në shtetin ku ato realizohen.

Neni 103

Investimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike

1. Shoqëria e sigurimit investon provigjonet teknike dhe matematike në aktive të llojeve të ndryshme, që janë ekuivalente me provigjonet teknike të krijuara prej saj.

2. Investimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike bëhet në mënyrë të tillë që të sigurohet ruajtja e vlerës, përfitueshmëria dhe likuiditeti nga investimet.

3. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të sigurojë ruajtjen e vlerës së investimeve të aseteve në mbulim të provigjoneve teknike me përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, ndaj ekspozimit të rreziqeve të mundshme, si ndryshimi i normave të interesit, luhatjet e kursit të këmbimit valutor dhe rreziqe të tjera të tregut, në të cilat këto ndryshime kanë ndikim.

4. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të sigurojë ruajtjen e vlerës së investimeve të aseteve në mbulim të provigjoneve matematike me përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës, ndaj ekspozimit të luhatjeve të kursit të këmbimit valutor jo më pak se 80 për qind.

5. Shoqëria e sigurimit, sa herë që investohen asetet në mbulim të provigjoneve teknike, duhet të marrë në konsideratë maturimin e përgjegjësive që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

6. Rregullat e vlerësimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 104

Ndarja e aktiveve

1. Shoqëria e sigurimit detyrohet të ndajë aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike nga aktivet e tjera të shoqërisë.

2. Shoqëria e sigurimit detyrohet të mbajë regjistër të veçantë për evidentimin e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike nga aktivet e tjera të shoqërisë.

3. Shoqëria e sigurimit detyrohet të mbajë llogari të veçanta bankare, të miratuara paraprakisht nga Autoriteti, për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe aktivet e tjera të shoqërisë.

Neni 105

Kategoritë e investimeve të lejuara

1. Aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike investohen si më poshtë:

a) Investime;

i) letra me vlerë të Qeverisë dhe të borxhit publik;

ii) letra borxhi;

iii) aksione si pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, të listuar në një treg të rregulluar ligjshëm;

iv) aksione në skemat e investimeve kolektive dhe fonde të tjera investimesh;

v) toka, ndërtesa dhe të drejta mbi pasuri të patundshme;

b) kërkesa debitore dhe kërkesa për dëmshpërblime:

i) borxhe të zotëruara nga risiguruesit, përfshirë pjesën e risigurimeve në provigjonet teknike;

ii) depozita me shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;

iii) borxhe të zotëruara nga të siguruarit dhe ndërmjetësit në sigurime, që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimit dhe e risigurimit;

iv) shuma për t'u kthyer nga taksat;

v) pagesa paraprake të bëra në lidhje me vlerën e kontratave të sigurimit;

- vi) kërkesa përkundrejt fondit të garancisë.
- c) të tjera:
 - i) para në bankë dhe në arkë, depozita në institucione krediti dhe në çdo institucion tjetër të autorizuar për pranim depozitash;
 - ii) interesa dhe qira të maturuara, të ardhura të tjera të maturuara dhe parapagesa;
 - iii) aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në paragrafin “v” të shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni, të vlerësuar në bazë të normave të amortizimit;
 - iv) interesa të kthyeshëm.
- 2. Kategori të tjera investimesh të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe kufijtë maksimalë të lejueshëm të investimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 106

Ndalimi i përdorimit të lirë të pasurive

1. Autoriteti ndalon përdorimin e lirë të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike në goftë se shoqëria e sigurimit nuk respekton dispozitat e neneve 101, 102, 103, 104 dhe 105 të këtij ligji.
2. Autoriteti merr masat e nevojshme, që kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve, nënshkrues apo përfitues të kontratave të sigurimit.
3. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti përcakton me rregullore të tij procedurat e ndalimit të lirë të pasurive të shoqërisë së sigurimit.

SEKSIONI IV

RREGULLA TË TJERA TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT

Neni 107

Detyrimi për risigurim

1. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të risigurojë në një shoqëri risigurimi përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, të cilat, në bazë të tabelave të mbulimit maksimal, tejkalojnë mbulimin e mundshëm nga aktivet e shoqërisë së sigurimit.
2. Shoqëria e sigurimit nuk mund të marrë në sigurim përgjegjësi që tejkalon mbulimin maksimal të saj.
3. Mbulimi maksimal i shoqërisë së sigurimit përfaqëson tejkalimin me 10 për qind të kapitalit të shoqërisë për çdo rrezik të veçantë.
4. Shoqëria e sigurimit detyrohet të nënshkruajë marrëveshje risigurimi vetëm me shoqëri risigurimi që përmbushin nivelet ndërkombëtare të pagesës së dëmeve, sipas kriterëve të përcaktuara nga Autoriteti, të listuara mbi bazën e vlerësimeve ndërkombëtare.

Neni 108

Programi i risigurimit

1. Shoqëria e sigurimit për çdo vit financiar është e detyruar të zbatojë një program të nevojave për risigurime.
2. Programi i risigurimeve përmban:
 - a) tabelën e mbulimeve maksimale të hartuar në bazë të kapitalit të shoqërisë, provigjoneve statutorë dhe primeve për çdo klasë sigurimi;
 - b) procedurat, bazat dhe kriteret e përcaktimit të propabilitetit më të lartë të humbjeve në lidhje me rreziqet e marra në sigurim dhe nivelin i mbulimit të rënë dakord paraprakisht.

3. Në llogaritjet referuar shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2, shoqëria e sigurimit merr në konsideratë:

- a) madhësinë e kapitalit dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese;
- b) volumin total të veprimtarisë;
- c) primet e sigurimit të grumbulluara brenda grupeve dhe klasave të sigurimit;
- ç) nivelin e mbulimit të rënë dakord për çdo klasë të sigurimeve;
- d) rregullimet si pasojë e shmangieve brenda klasave të veçanta të sigurimeve.

4. Shoqëria e sigurimit paraqet programin e risigurimeve të parashikuar në pikën 2 të këtij neni tek Autoriteti jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga fillimi i vitit të ri financiar.

5. Autoriteti shprehet për programin e risigurimeve të parashikuar në pikën 2 të këtij neni brenda 45 ditëve kalendarike nga data e depozimit të këtij programi tek Autoriteti.

6. Autoriteti përcakton me rregullore kërkesat e pikës 2 të këtij neni.

Neni 109 **Bashkësigurimi**

Shoqëria e sigurimit, për çdo klasë të sigurimeve, nuk bashkësiguron një nivel rreziku që tejkalon aftësinë e saj të mbulimit, në përputhje me tabelat e mbulimit maksimal të parashikuara në pikën 2 të nenit 108 të këtij ligji.

Neni 110 **Menaxhimi i likuiditetit**

1. Shoqëria e sigurimit menaxhon aktivet e saj, në mënyrë të tillë që në çdo kohë të sigurojë shlyerjen e përgjegjësisë që rrjedhin nga kontratat e nënshkruara të sigurimit.

2. Shoqëria e sigurimit llogarit normat e likuiditetit dhe nivelin minimal të tyre mbi bazën e metodave të përcaktuara.

3. Metodatat e llogaritjes së normave të likuiditetit dhe nivelit minimal të likuiditetit përcaktohen me rregullore të Autoritetit.

Neni 111 **Kufizimi në shpërndarjen e fitimit**

Autoriteti ndalon shoqërinë e sigurimit të shpërndajë fitim nëse:

a) aftësia paguese e shoqërisë së sigurimit ka rënë nën nivelin e kërkuar të aftësisë paguese;

b) nga shpërndarja e dividendit të vitit paraardhës, aftësia paguese e shoqërisë së sigurimit bie nën nivelin e kërkuar;

c) shoqëria e sigurimit nuk siguron nivelin minimal të likuiditetit të llogaritur, sipas metodave të hartuara nga Autoriteti;

ç) nga shpërndarja e dividendit të vitit paraardhës shoqëria e sigurimit nuk siguron nivelin minimal të likuiditetit;

d) shoqëria e sigurimit nuk ka zbatuar vërejtjet e Autoritetit për pasqyrimin e papërshtatshëm të zërave të bilancit, të cilat ndikojnë në llogarinë humbje -fitime të shoqërisë.

Neni 112 **Llogaritja dhe kontrolli**

1. Shoqëria e sigurimit të jo-jetës është e detyruar të llogarisë dhe të kontrollojë çdo tre muaj:

- a) kapitalin e shoqërisë;

- b) aftësinë paguese;
- c) nivelin e kërkuar të aftësisë paguese;
- ç) provigjonet teknike;
- d) aktivet në mbulim të provigjoneve teknike;
- dh) investimin e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike;
- e) normat e likuiditetit;
- ë) përgjegjësitë e marra nga shoqëria për çdo klasë sigurimi;
- f) kalimet në risigurime;
- g) të dhëna të tjera të kërkuara nga Autoriteti.

2. Shoqëria e sigurimit të jetës llogarit dhe kontrollon çdo tre muaj të dhënat e parashikuara në shkronjat “d”, “dh”, “e” dhe “g” të pikës 1 të këtij neni. Shoqëria e sigurimit të jetës në fund të çdo viti financiar paraqet në Autoritet një raport të hartuar nga aktuari i autorizuar, i cili përmban deklarime në lidhje me provigjonet matematike, aftësinë paguese, përshtatshmërinë e aktiveve në mbulim të provigjoneve, mjaftueshmërinë e primeve dhe një analizë të tepricës ose mungesës së fitimit të llogaritur.

3. Shoqëria e sigurimit depoziton tek Autoriteti një raport me të dhënat e kërkuara në pikën 1 të këtij neni brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori.

Neni 113

Dega e shoqërisë së huaj

Dispozitat e këtij kreu janë të zbatueshme edhe për degët e shoqërive të huaja, të licencuara për të ushtruar veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU VII

MBAJTJA E KONTABILITETIT DHE GJENDJA FINANCIARE E SHOQËRISË SË SIGURIMIT

Neni 114

Mbajtja e kontabilitetit

1. Shoqëria e sigurimit mban kontabilitetin dhe përgatit raporte financiare në përputhje me dispozitat e ligjit të kontabilitetit, përveçse kur kërkohet ndryshe nga Autoriteti.

2. Shoqëria e sigurimit mban librat e kontabilitetit, regjistrat e kërkuar nga ky ligj dhe çdo libër tjetër të kërkuar nga Autoriteti, si dhe dokumentet vërtetuese të veprimeve financiare, dokumentet e veprimtarisë dhe regjistrime të tjera, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 115

Lista e dokumenteve të llogaridhënies së detajuar

Shoqëria e sigurimit dhe shoqëria e brokerimit paraqesin në Autoritet një llogaridhënie të detajuar të veprimtarisë së saj në përputhje me formën, listën dhe afatet e përcaktuara me udhëzim të Autoritetit.

Neni 116

Raportimi

1. Shoqëria e sigurimit përgatit raporte financiare dhe raporte të tjera të veprimtarisë për çdo vit kalendarik dhe i paraqet në Autoritet brenda 31 marsit të vitit pasardhës.

2. Përjashtim nga pika 1 e këtij neni bëjnë shoqëritë e sigurimit që fillojnë veprimtarinë për herë të parë në gjashtëmujorin e dytë të vitit në vazhdim, të cilat mund të raportojnë në

mbarim të vitit pasardhës.

3. Shoqëria e sigurimit përgatit raporte financiare dhe raporte të tjera të veprimtarisë për periudha edhe më të shkurtra se viti kalendarik, në zbatim të akteve ligjore në fuqi dhe regulloreve të Autoritetit.

4. Autoriteti publikon raportet e përmbledhura financiare të shoqërisë së sigurimit së bashku me një raport të shkurtuar të ekspertit kontabël të autorizuar në buletin periodik të tij.

Neni 117

Verifikimi i aktuarit të autorizuar

Raportimi i shoqërisë së sigurimit përfshin edhe raportin e aktuarit të autorizuar, nëse primet, provigjonet teknike dhe investimi i tyre, fondi i garancisë, niveli i kërkuar i aftësisë paguese, aftësia paguese, kalimet në risigurim etj. janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi.

Neni 118

Transaksionet financiare dhe pagesat e dëmeve

1. Transaksionet financiare dhe pagesat e dëmeve nga shoqëria e sigurimit kryhen nëpërmjet bankave të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

2. Transaksionet financiare nga shoqëria e brokerimit kryhen nëpërmjet bankave të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

3. Shoqëria e sigurimit dhe shoqëria e brokerimit depozitojnë në Autoritet emrat e bankave, numrat e llogarive rrjedhëse dhe të depozitave me të cilat ata operojnë në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 119

Degët e shoqërive të huaja

Dispozitat e këtij kreu janë të zbatueshme edhe për degët e shoqërive të huaja të licencuara për të ushtruar veprimtari sigurimi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU VIII MBIKËQYRJA

Neni 120

Fusha e mbikëqyrjes

1. Autoriteti është i vetmi institucion që mbikëqyr veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj, me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve.

2. Autoriteti ushtron mbikëqyrje mbi veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit, degën e shoqërisë së huaj të sigurimit, agjentëve, agjencive, brokerave dhe shoqërive të brokerimit vendase ose të huaja.

3. Autoriteti ushtron mbikëqyrje mbi veprimtarinë e subjekteve të tjera të licencuara prej tij.

4. Autoriteti ushtron mbikëqyrje mbi veprimtarinë e personave juridikë me të cilët shoqëria e sigurimit është pjesëmarrëse. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve ushtron këtë mbikëqyrje në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse të tyre.

Neni 121
Ushtrimi i mbikëqyrjes

1. Mbikëqyrja e shoqërisë së sigurimit dhe e degës së shoqërisë së huaj ushtrohet nëpërmjet:

- a) kontrollit dokumentar;
- b) analizës dokumentare dhe kontrollit në vend, i cili mund të jetë i pjesshëm ose i plotë;
- c) ndërhyrjes dhe zbatimit të masave të përcaktuara nga ky ligj.

2. Autoriteti, në kuadrin e mbikëqyrjes, u kërkon shoqërive të sigurimit dhe degëve të shoqërive të huaja çdo informacion dhe dokument që ka lidhje me veprimtarinë e tyre.

3. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj është e detyruar t'i vërë në dispozicion Autoritetit çdo dokument të kërkuar, sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 122
Raportimi në Autoritet

1. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj raportojnë dhe depozitojnë në Autoritet:

- a) çdo propozim për ndryshim të të dhënave në regjistrin tregtar;
- b) njoftimet për thirrjen e asamblesë së përgjithshme të aksionerëve dhe vendimet e marra në të;
- c) listën e aksionerëve të shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë të huaj, pjesëmarrjen e tyre në kapitalin aksioner;
- ç) shkarkimin dhe propozimin për emërimin e anëtarëve të drejtorisë;
- d) investimet e shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë të huaj;
- dh) ndryshimin e strukturës së kapitalit;
- e) kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratave të reja të sigurimit dhe ndryshimet për ato ekzistuese;
- ë) tarifat e primeve;
- f) marrëveshjet e risigurimit të nënshkruara me risiguruesin ;
- g) produktet e reja të sigurimit;
- gj) materiale me karakter publicitar;
- h) përmirësimin e plan - biznesit;
- i) ndryshimin e selisë së shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë të huaj;
- j) kontratën me agjentin, shoqërinë e agjentëve, brokerin, shoqërinë e brokerimit, vlerësuesin e dëmeve, konsulentin në sigurime dhe aktuarin, kur këto veprimtari ushtrohen nga persona fizikë apo juridikë të huaj të licencuar në vendin e origjinës.

2. Drejtoria e shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë të huaj njofton menjëherë me shkrim Autoritetin kur:

- a) likuiditeti ose aftësia paguese e shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë së huaj rrezikohet;
- b) gjendja financiare e shoqërisë së sigurimit, përkeqësohet dhe ajo nuk është në gjendje të sigurojë nivelin e kërkuar të aftësisë paguese.

3. Autoriteti, në përputhje me këtë nen, harton rregulla të detajuara për përmbajtjen, mënyrën dhe afatet e raportimit.

Neni 123
Masat e mbikëqyrjes

Autoriteti, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, merr ndaj shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë të huaj këto masa:

- a) vendos sanksione;
- b) urdhëron eliminimin e shkeljeve të dispozitave ligjore dhe marrjen e masave korrigjuese;
- c) tërheq licencën;
- ç) shpall administrimin e përkohshëm;
- d) fillon procedurat e likuidimit të detyrueshëm të shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë të huaj;
- dh) fillon procedurat e falimentimit ndaj shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë së huaj.

Neni 124

Urdhri për eliminimin e shkeljeve të dispozitave ligjore

1. Autoriteti nxjerr urdhër për eliminimin e shkeljeve në qoftë se gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë së huaj konstaton se:

- a) anëtari i drejtorisë nuk ka marrë miratimin e përcaktuar, sipas nenit 63 të këtij ligji;
- b) shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj nuk përmbushin kushtet për ushtrimin e veprimtarisë;
- c) shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj ushtrojnë veprimtari në klasa për të cilat nuk janë licencuar;
- ç) shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj shkelin rregullat e menaxhimit të rrezikut;
- d) shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj shkelin rregullat e parashikuara në pikën 2 të nenit 114 të këtij ligji;
- dh) shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj shkelin rregullat që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe të ekspertit kontabël të autorizuar;
- e) shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj shkelin detyrimin në lidhje me raportimin e parashikuar në nenin 116 të këtij ligji.
- ë) shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj shkelin dispozitat e këtij ligji, si dhe aktet e tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Autoriteti përcakton afatet e eliminimit të shkeljeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 125

Raporti i eliminimit të shkeljeve

1. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj, brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti, i paraqesin atij një raport të detajuar për masat e marra për eliminimin e shkeljeve.

2. Autoriteti, me marrjen e raportit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, verifikon eliminimin e shkeljeve.

3. Autoriteti merr vendim brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e raportit për eliminimin e shkeljeve.

Neni 126

Zbatimi i masave korrigjuese

1. Autoriteti, nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së veprimtarisë të shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë të huaj, konstaton shkelje të rënda të rregullave të menaxhimit të rrezikut, përveç urdhrimit për eliminimin e shkeljeve të parashikuara në pikën 1 të nenit 124 të këtij ligji, urdhëron drejtorinë e shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë së huaj:

- a) të hartojë një plan për të arritur nivelin e kërkuar të aftësisë paguese të shoqërisë;
- b) të thërrasë asamblenë e përgjithshme të aksionerëve dhe t'i propozojë:
 - i) rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë të huaj nëpërmjet investimeve të reja;
 - ii) rritjen e kapitalit themeltar me anë të fitimit (duke mos shpërndarë dividendë);
- c) të ndalojë lidhjen e kontratave të reja të sigurimit;
- ç) të ndalojë kryerjen e pagesave për persona juridikë të caktuar;
- d) të ndalojë ose të kufizojë përdorimin e lirë të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike ose matematike;

2. Autoriteti urdhëron këshillin mbikëqyrës të shkarkojë një ose disa anëtarë të drejtorisë dhe zëvendësimin e tyre brenda një periudhe 1-mujore. Personat e komanduar, si anëtarë të drejtorisë dhe të miratuar nga Autoriteti, nuk mund të shërbejnë në këtë post më shumë se një periudhë 1-mujore.

3. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, konsiderohen shkelje të rënda të rregullave të menaxhimit të rrezikut nëse:

- a) aftësia paguese e shoqërisë ka rënë nën nivelin e kërkuar;
- b) aftësia paguese e shoqërisë bie nën minimumin e fondit të garancisë, parashikuar në nenin 98 të këtij ligji;
- c) kryen veprimtari, për të cilat shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj nuk janë licencuar;
- ç) shpërndan dividendin në kundërshtim me nenin 111 të këtij ligji;
- d) shkel dispozitat e neneve 100, 101, 102, 103, 104, 105 dhe 107 të këtij ligji;
- dh) nuk përmbush detyrimin për raportimin e saktë dhe në kohë pranë Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve;
- e) kryen transaksione të rreme me qëllim paraqitjen jo të saktë të gjendjes financiare të shoqërisë së sigurimit ose degës së shoqërisë të huaj;
- ë) kryen veprimtari të tjera, të cilat rrezikojnë likuiditetin dhe aftësinë paguese të shoqërisë.

4. Autoriteti, rast pas rasti, me vendim të tij përcakton afatet e përmbushjes së masave korrigjuese shtesë, të cilat në asnjë rast nuk duhet të jenë jo më pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 3 muaj nga data e marrjes së vendimit.

Neni 127

Rimëkëmbja financiare

1. Autoriteti urdhëron shoqërinë e sigurimit dhe degën e shoqërisë së huaj të paraqesin për miratim një plan afatgjatë për vendosjen e gjendjes financiare të qëndrueshme në qoftë se aftësia paguese e shoqërisë ka rënë nën nivelin e kërkuar, parashikuar në nenet 96 dhe 97 të këtij ligji.

2. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj duhet të paraqesin në Autoritet planin afatgjatë brenda 3 muajve nga data e marrjes së urdhrit.

3. Plani financiar afatgjatë duhet të përfshijë objektivat dhe mënyrën e realizimit të tyre në tre vjetët e ardhshëm dhe përfshin:

- a) vlerësimin e shpenzimeve administrative, në veçanti shpenzimet e përgjithshme dhe komisionet;
- b) planin e detajuar të vlerësimit të të ardhurave në lidhje me veprimtarinë e drejtpërdrejtë të sigurimit, pranimet dhe kalimet në risigurim;
- c) parashikimin e bilancit;
- ç) vlerësimin e burimeve financiare të nevojshme për të mbuluar përgjegjësitë dhe llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese;
- d) strategjinë e përgjithshme të risigurimeve.

4. Autoriteti, gjithashtu, ka të drejtë të marrë masat e parashikuara në nenin 106 të këtij ligji, në qoftë se aftësia paguese e shoqërisë bie nën minimumin e fondit të garancisë së parashikuar në nenin 98 të këtij ligji.

5. Autoriteti, në kuptim të pikës 3 të këtij neni, i kërkon shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë së huaj të paraqesin për miratim një plan financiar afatshkurtër brenda një muaji nga data e marrjes së urdhrin të Autoritetit.

6. Autoriteti merr vendim për miratimin ose refuzimin e planit financiar afatshkurtër brenda 1 muaj nga paraqitja e tij.

Neni 128

Tërheqja e licencës

1. Autoriteti tërheq licencën e dhënë nëse:

a) shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj nuk kanë eliminuar shkeljet e parashikuara në nenin 124 të këtij ligji;

b) shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj nuk kanë plotësuar masat korrigjuese shtesë të parashikuara në pikën 1 të nenit 126 të këtij ligji;

c) shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj refuzojnë të përmbushin kërkesat e nenit 121 të këtij ligji;

ç) shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj nuk kanë përmbushur dispozitat e nenit 127 të këtij ligji.

2. Tërheqja e licencës mund të jetë e pjesshme ose tërësore. Autoriteti tërheq licencën për të ushtruar veprimtari sigurimi për klasa të veçanta.

Neni 129

Njoftimi për tërheqjen e licencës

1. Vendimi i Autoritetit për tërheqjen e licencës i njoftohet shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë së huaj brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

2. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj, me marrjen e njoftimit për tërheqjen e licencës, nuk duhet:

a) të lidhin kontrata të reja sigurimi;

b) të rinovojnë kontrata sigurimi;

c) të zgjerojnë mbulimin në sigurim për kontratat në fuqi;

ç) të rrisin primin e sigurimit.

3. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj brenda 10 ditëve kalendarike depozitojnë në Autoritet licencën.

4. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj vazhdojnë të jenë subjekt i dispozitave të këtij ligji edhe pas tërheqjes së licencës nga Autoriteti.

Neni 130

Ankimi

Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj bëjnë ankim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të tërheqjes së licencës, në përputhje me parashikimet e bëra në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 131

Publikimi

Vendimi për tërheqjen tërësore ose pjesore të licencës për ushtrim veprimtarie sigurimi

botohet në Fletoren Zyrtare dhe në dy gazeta kombëtare me tirazh më të madh. Për rastet e parashikuara në nenin 130 të këtij ligji, vendimi publikohet, pasi ka marrë formë të prerë, brenda pesë ditëve kalendarike.

KREU IX
ADMINISTRIMI I PËRKOHSHËM, LIKUIDIMI DHE FALIMENTIMI

SEKSIONI I
ADMINISTRIMI I PËRKOHSHËM

Neni 132

Vendimi për administrimin e përkohshëm

1. Autoriteti merr vendim për administrimin e përkohshëm të shoqërisë së sigurimit me qëllim rikthimin e saj në një situatë të shëndoshë financiare nëse:

a) shoqëria e sigurimit e urdhëruar të marrë masat shtesë, në përputhje me nenin 126 të këtij ligji, nuk ka filluar zbatimin e këtyre masave ose nuk i ka zbatuar këto masa, sipas afateve të përcaktuara nga Autoriteti;

b) shoqëria e sigurimit, pavarësisht se ka filluar zbatimin e masave shtesë, nuk ka arritur nivelin e kërkuar të aftësisë paguese;

c) veprimtaria e mëtejshme e shoqërisë së sigurimit rrezikon likuiditetin ose aftësinë paguese të saj.

2. Autoriteti zgjedh dhe emëron administratorin e përkohshëm që do të marrë në administrim dhe kontroll shoqërinë e sigurimit.

3. Autoriteti përcakton periudhën kohore të administrimit të përkohshëm, e cila nuk mund të zgjasë më shumë se 12 muaj.

Neni 133

Administratori i përkohshëm

1. Autoriteti emëron një ose disa administratorë të përkohshëm dhe përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat e tij brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit.

2. Paga e administratorit të përkohshëm, shpenzimet për ushtrimin e funksioneve të tij në lidhje me administrimin e përkohshëm përballohen nga shoqëria e sigurimit.

Neni 134

Efektet juridike të administrimit të përkohshëm

1. Në datën e marrjes së njoftimit për vendimin e Autoritetit, në lidhje me administrimin e përkohshëm të shoqërisë, përgjegjësitë dhe kompetencat e anëtarëve të drejtorisë, të këshillit mbikëqyrës, asamblesë së aksionereve pezullohen për gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm.

2. Autoriteti jep udhëzime për administratorin e përkohshëm për menaxhimin e shoqërisë së sigurimit, të detyrueshme për t'u zbatuar prej tij.

3. Dispozitat e këtij ligji në lidhje me drejtorinë e shoqërisë janë të zbatueshme dhe për administratorin e përkohshëm nëse nuk përcaktohet ndryshe nga Autoriteti në udhëzimet e dhëna.

Neni 135

Detyrimi për t'i raportuar administratorit të përkohshëm

1. Anëtarët e drejtorisë të shoqërisë së sigurimit detyrohen të vënë në dispozicion të administratorit të përkohshëm të gjitha dokumentet e veprimtarisë së sigurimit të shoqërisë dhe të përgatisin një raport për gjendjen e saj.

2. Anëtarët e drejtorisë të shoqërisë së sigurimit, me kërkesën e administratorit të përkohshëm, detyrohen të japin informacion me shkrim dhe raporte shtesë për veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit.

3. Administratori i përkohshëm ka të drejtë të shkarkojë çdo person që refuzon të japë informacionin e kërkuar, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 136

Raportimi në Autoritet

1. Administratori i përkohshëm raporton periodikisht në Autoritet për ecurinë e administrimit të përkohshëm. Afatet dhe forma e raportimit periodik përcaktohen rast pas rasti nga Autoriteti.

2. Administratori i përkohshëm detyrohet çdo tre muaj t'i paraqesë Autoritetit një raport të gjendjes financiare të shoqërisë, si dhe të ecurisë së veprimtarisë së saj në kushtet e administrimit të përkohshëm.

3. Administratori i përkohshëm është i detyruar që brenda 9 muajve nga data e emërimit të tij, të përgatisë dhe t'i paraqesë Autoritetit një raport mbi gjendjen financiare, ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit në kushtet e administrimit të përkohshëm, vlerësimin e qëndrueshmërisë ekonomike dhe mundësive për vazhdimësinë ose jo të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

Neni 137

Rritja e kapitalit themeltar për sigurimin e qëndrueshmërisë ekonomike

1. Autoriteti, në bazë të raporteve të administratorit të përkohshëm dhe në përputhje me pikat 1 dhe 2 të nenit 136 të këtij ligji, kur e çmon të nevojshme, urdhëron administratorin e përkohshëm të thërrasë asamblenë e jashtëzakonshme të aksionereve të shoqërisë, dhe t'i kërkojë rritjen e kapitalit themeltar.

2. Administratori i përkohshëm është i detyruar të thërrasë mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme të aksionerëve jo më vonë se 10 ditë pas marrjes së urdhrit të Autoritetit, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Administratori i përkohshëm vë në dijeni asamblenë e jashtëzakonshme të aksionerëve që në rast se refuzohet rritja e kapitalit themeltar, sipas pikës 1 të këtij neni, shoqëria, në zbatim të shkronjës "ç" të nenit 154 të këtij ligji, kalon në falimentim.

Neni 138

Vlerësimi i rezultateve nga Autoriteti

1. Autoriteti bën vlerësimin e rezultateve të administrimit të përkohshëm çdo 3 muaj.

2. Autoriteti harton një raport vlerësimi përfundimtar të administrimit të përkohshëm brenda 3 muajve nga marrja e raportit, parashikuar në pikën 3 të nenit 136 të këtij ligji.

3. Autoriteti vendos për përfundimin e administrimit të përkohshëm nëse:

a) vlerëson se gjendja financiare e shoqërisë së sigurimit është përmirësuar gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm;

b) shoqëria ka përmbushur të gjitha detyrimet e saj;

c) shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj normalisht.

4. Autoriteti, nëse vlerëson se gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm nuk janë përmbushur kërkesat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, vendos për fillimin e procedurave të likuidimit ose përcakton kushtet për fillimin e procedurave të falimentimit.

SEKSIONI II LIKUIDIMI

Neni 139

Likuidimi vullnetar

1. Nëse aksionerët e një shoqërie sigurimi vendosin vullnetarisht të kalojnë shoqërinë në likuidim, shoqëria duhet të njoftojë më parë Autoritetin.
2. Autoriteti pranon likuidimin vullnetar dhe merr masa për mbrojtjen e interesave të të siguruarve.

Neni 140

Shkaqet për fillimin e procedurave të likuidimit të detyruar

1. Autoriteti vendos për fillimin e procedurave të likuidimit nëse:
 - a) është tërhequr licenca e shoqërisë së sigurimit për të ushtruar veprimtari sigurimi;
 - b) kur një gjë e tillë kërkohet nga kreditorët.
2. Autoriteti vendos për fillimin e procedurave të likuidimit brenda 20 ditëve kalendarike nga:
 - a) data e marrjes së vendimit për tërheqjen e licencës, parashikuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni;
 - b) data e depozitimit të kërkesës nga kreditorët.
3. Autoriteti depoziton një kërkesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për fillimin e procedurave të likuidimit.

Neni 141

Fillimi i procedurave të likuidimit për shoqëritë e sigurimit

1. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë është gjykata kompetente për fillimin dhe zbatimin e procedurave të likuidimit për shoqëritë e sigurimit.
2. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë emëron dy ose më shumë likuidatorë.
3. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë vendos për hapjen e procedurave të likuidimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës nga Autoriteti.

Neni 142

Vendimi për fillimin e procedurave të likuidimit për shoqëritë e sigurimit

1. Vendimi i gjykatës për fillimin e procedurave të likuidimit përmban:
 - a) emrin e shoqërisë së sigurimit, adresën e selisë qendrore dhe numrat e llogarive bankare;
 - b) emrin e plotë dhe adresën e likuidatorit;
 - c) datën e fillimit të likuidimit.
2. Në bazë të vendimit për fillimin e procedurave të likuidimit, shoqëria regjistrohet në regjistrin tregtar si shoqëri në likuidim e sipër.

Neni 143

Njoftimi i vendimit për fillimin e procedurave të likuidimit

1. Kreditorët informohen për vendimin e fillimit të procedurave të likuidimit nëpërmjet njoftimit publik.
2. Njoftimi për vendimin e gjykatës botohet në Fletoren Zyrtare, në buletinin e gjykatës dhe të paktën në dy gazeta të përditshme kombëtare përgjatë 5 ditëve të njëpasnjëshme jo më

vonë se 3 ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit të gjykatës.

3. Njoftimi i likuidimit përmban:

a) gjykatën që ka dhënë vendimin;

b) kopjen e vendimit;

c) emrin e shoqërisë së sigurimit, adresën e selisë;

ç) emërimin e likuidatorit;

d) ftesën për kreditorët e shoqërisë së sigurimit për të regjistruar pretendimet e tyre;

dh) ftesën për debitorët e shoqërisë së sigurimit për shlyerjen e menjëhershme të detyrimeve të tyre;

e) datën e botimit në buletin e gjykatës.

4. Vendimi i gjykatës për fillimin e procedurave të likuidimit i njoftohet Autoritetit, shoqërisë së sigurimit dhe bankave, me të cilat shoqëria kryen transaksione bankare.

Neni 144

Ndalimi për të lidhur kontrata të reja sigurimi

1. Shoqëria e sigurimit, me marrjen e njoftimit për fillimin e procedurave të likuidimit, ndalohet:

a) të lidhë kontrata të reja sigurimi;

b) të ripërtërijë kontrata sigurimi.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, shoqëria e sigurimit mund të lidhë kontrata të nevojshme për kthimin e aktiveve në likuiditet me miratimin paraprak të likuidatorit.

Neni 145

Efektet e likuidimit për shoqëritë e sigurimit

Të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të drejtorisë dhe këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit, si dhe të drejtat e asamblesë së aksionerëve përfundojnë nga data e marrjes së vendimit për fillimin e procedurave të likuidimit.

Neni 146

Përgatitja e bilancit nga likuidatori

1. Likuidatori përgatit bilanc dhe raport sqarues në lidhje me zërat e bilancit të shoqërisë në likuidim brenda 30 ditëve kalendarike nga data e fillimit të procedurave të likuidimit.

2. Likuidatori paraqet në gjykatën kompetente dhe në Autoritet bilancin dhe raportin, sipas pikës 1 të këtij neni brenda 15 ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 147

Të drejtat dhe përgjegjësitë e likuidatorit

1. Likuidatori ka të drejtat dhe përgjegjësitë e drejtorisë së shoqërisë së sigurimit. Likuidatori përfaqëson shoqërinë e sigurimit.

2. Likuidatorit dhe personave të emëruar për të përfaqësuar ose ndihmuar atë, nuk mund t'u paguhen shuma më të mëdha se ato që u janë paguar punonjësve të shoqërisë së sigurimit për shërbime të ngjashme.

3. Likuidatori nënshkruan në të gjitha aktet e dokumentet e nxjerra nga shoqëria, të cilat përmbajnë emërtimin e saj, duke u pasuar nga shënimi "shoqëri në likuidim".

Neni 148

Përfundimi i kontratave

Vlefshmëria e kontratave të sigurimit të lidhura me shoqërinë e sigurimit do të përfundojë pas 30 ditësh kalendarike nga dita e fillimit të procedurave të likuidimit.

Neni 149

Shpërndarja e aktiveve

1. Likuidatori përcakton detyrimet ndaj kreditorëve, pretendimet e personave të tretë ndaj shoqërisë së sigurimit në likuidim, përgjegjësitë e mbetura pezull të të siguruarve, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe kthen në likuiditet aktivet e mbetura.

2. Likuidatori përgatit një regjistër, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, të cilin e paraqet në gjykatën kompetente dhe në Autoritet.

3. Likuidatori njofton gjykatën kompetente për kthimin në likuiditet të aktiveve të mbetura dhe i propozon asaj shpërndarjen e tyre.

4. Gjykata kompetente merr vendim për shpërndarjen e likuiditeteve kreditorëve, pretendimet e të cilëve janë pranuar.

Neni 150

Përparësitë në shpërndarjen e aktiveve

1. Shpërndarja e likuiditeteve bëhet sipas përparësive të mëposhtme:

a) pagesat e shpenzimeve të domosdoshme dhe të arsyeshme për kryerjen e procedurave të likuidimit;

b) pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve të palikuiduara deri në datën e fillimit të procedurave të likuidimit me vendim të gjykatës;

c) dëmshpërblimet e të siguruarve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit;

ç) primet e pafituara;

d) taksat dhe detyrimet që ka shoqëria e sigurimit deri në datën e fillimit të procedurave të likuidimit me vendim të gjykatës;

dh) kreditorë të tjerë.

2. Nëse likuiditetet janë të pamjaftueshme për të bërë pagesat e plota, sipas përparësive të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, këto pagesa zvogëlohen proporcionalisht.

3. Likuiditetet e mbetura, pasi janë plotësuar kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndahen midis aksionerëve të shoqërisë së sigurimit në raport me vlerën nominale të aksioneve.

Neni 151

Pagesat e të siguruarve për kontratat e sigurimit të jetës

Në rastet e likuidimit të shoqërisë së sigurimit që ushtron veprimtari në sigurimin e jetës, aktivet në mbulim të provigjoneve matematike do të përdoren për të bërë pagesat vetëm për përgjegjësitë që burojnë nga kontratat e sigurimit të jetës.

Neni 152

Raportimi në Autoritet

Likuidatori paraqet në Autoritet raporte në lidhje me ecurinë e procedurave të likuidimit çdo tre muaj.

Neni 153

Çregjistrimi nga regjistri tregtar

Me përfundimin e procedurave të likuidimit, shoqëria e sigurimit çregjistrohet nga regjistri tregtar.

SEKSIONI III FALIMENTIMI

Neni 154

Shkaqet për fillimin e procedurave të falimentimit

Autoriteti vendos për fillimin e procedurave të falimentimit nëse:

- a) në bazë të raportit, parashikuar në nenin 136 të këtij ligji, vlerëson se gjatë administrimit të përkohshëm gjendja financiare e shoqërisë nuk është përmirësuar dhe shoqëria nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet ndaj kreditorëve;
- b) gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së shoqërisë së sigurimit konstatohet se aktivet e saj janë të pamjaftueshme për të përmbushur detyrimet e kreditorëve;
- c) shoqëria e sigurimit ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe e për pasojë nuk ka mundësi të vazhdojë veprimtarinë dhe të përmbushë detyrimet e kreditorëve në datën e maturimit;
- ç) asambleja e përgjithshme e aksionerëve refuzon propozimin e parashikuar në pikën 1 të nenit 137 të këtij ligji.

Neni 155

Fillimi i procedurave të falimentimit

1. Autoriteti depoziton një kërkesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për fillimin e procedurave të falimentimit brenda 5 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.
2. Të drejtën për kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit e kanë kreditorët dhe likuiditorët e shoqërisë së sigurimit.
3. Gjykata i dërgon Autoritetit një kopje të kërkesës nëse kjo kërkesë është ngritur nga kreditorët.
4. Për procedurat e mëtejshme të falimentimit zbatohen dispozitat e neneve 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152 dhe 153 të këtij ligji.

KREU X MBROJTJA E KONSUMATORIT

Neni 156

Detyrimet e shoqërisë së sigurimit dhe të ndërmjetësit

1. Shoqëria e sigurimit, dega e shoqërisë së huaj dhe ndërmjetësit detyrohen:
 - a) të ushtrojnë veprimtarinë e tyre me profesionalizëm, kujdes dhe përkushtim ndaj të siguaruarve;
 - b) të veprojnë me mirëbesim dhe ndershmëri për respektimin e të drejtave të të siguaruarve;
 - c) të informojnë të siguaruarin për produktet e sigurimit, kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratave të sigurimit, përfitimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, tarifat dhe primet që i siguruari duhet të paguajë;
 - ç) të kryejnë pagesën e dëmshpërblimit në masën dhe në afatin e duhur.
2. Shoqëria e sigurimit, dega e shoqërisë së huaj dhe ndërmjetësit nuk duhet të japin informata ose të bëjnë prezantime që keqinformojnë ose mashtrojnë konsumatorin.

Neni 157

Kushtet e kontratës së sigurimit

1. Kontrata e sigurimit që mbulon rreziqe në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç sa është parashikuar në Kodin Civil, përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) ngjarjet e përjashtuara;
- b) pasojat juridike në rastet e mospagesës së tij;
- c) periudhën e vlefshmërisë së kontratës së sigurimit, e cila duhet të përfshijë:
 - i) mënyrën e rinovimit të kontratës;
 - ii) mënyrën e anulimit pjesor apo tërësor;
 - iii) përgjegjësitë e shoqërisë së sigurimit ose degës së shoqërisë së huaj në të tilla raste;
- ç) pasojat e mospërbushjes së detyrimeve, sipas kushteve të përcaktuara, në kontratat e sigurimit të jetës, si afatet, kushtet, shumën e pagesave paraprake, mënyrat e llogaritjes dhe pagesës së vlerës së përfituar nga anulimi i kontratës;
- d) trajtimi i shërbimeve të siguruesit;
- dh) rregulla të detajuara për axhustimin e primit;
- e) rregulla në rast kthimi të investimeve në fushën e sigurimit të jetës;
- ë) rregulla për kapitalizimin e anuiteteve në rastin e sigurimit të sëmundjeve, aksidenteve dhe palëve të treta, nëse ato shoqërohen me pagesa anuitetesh.

2. Kontrata e sigurimit për rreziqet që mbulon klasën 17, sipas klasifikimit të bërë në nenin 7 të këtij ligji, duhet të përfshijë mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit ligjor.

Neni 158

Njoftimi i të siguruarit gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit

1. Shoqëria e sigurimit, dega e shoqërisë së huaj dhe shoqëritë e brokerimit detyrohen që gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës të njoftojnë të siguruarin për çdo ndryshim, si më poshtë:

- a) të emrit, adresës së selisë së saj dhe degëve, nëpërmjet të cilave janë përfunduar kontratat e sigurimit;
- b) të kushteve të përgjithshme, periudhës së vlefshmërisë, shumës së primit, në qoftë se ndryshimet vijnë si rezultat i ndryshimeve të akteve të shoqërisë.

2. Çdo ndryshim në kushtet e kontratës së sigurimit gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj duhet të bëhet vetëm me shkrim dhe e nënshkruar nga palët.

Neni 159

Përmbajtja e kushteve të përgjithshme të kontratës

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit formulohen në gjuhën shqipe, të shprehura qartë dhe lehtësisht të kuptueshme.

Neni 160

Interesi mbi dëmshpërblimet

1. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj paguajnë interes mbi dëmshpërblimet e llogaritura, të barabartë me normat e interesit të depozitave bankare, në tejkallim të afatit të parashikuar dhe nënshkruar në kontratën e sigurimit për pagimin e dëmit.

2. Interesi i llogaritur mbi dëmshpërblimin, kur tejkallohet afati i pagimit të dëmit, bëhet duke iu referuar normave të interesit të depozitave të shpallur nga Banka e Shqipërisë, në raport me periudhën e vonesës dhe llojin e monedhës.

Neni 161
Të dhënat konfidenciale

1. Shoqëria e sigurimit, dega e shoqërisë së huaj dhe ndërmjetësit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve dhe rrethanave që kanë të bëjnë me të siguruarit, të dhëna me të cilat njihen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

2. Të njëjtin detyrim për ruajtjen e konfidencialitetit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni ka edhe Autoriteti në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij.

Neni 162
Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit

1. Anëtarët e drejtorisë, këshillit mbikëqyrës, aksionerët, të punësuarit dhe çdo person tjetër i shoqërisë së sigurimit dhe ndërmjetësimit, ndalohen të përdorin të dhënat konfidenciale për qëllime personale dhe dhënien e tyre personave të tretë.

2. Ruajtja e konfidencialitetit nuk respektohet nëse:

a) i siguruari miraton shprehimisht me shkrim nxjerrjen e tyre;

b) të dhënat kërkohen në procese gjyqësore dhe një kërkesë e tillë është bërë me shkrim nga gjykata kompetente;

c) të dhënat kërkohen në procese hetimore nga organi i prokurorisë;

ç) në rastet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave;

d) informacioni kërkohet nga Autoriteti ose nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes brenda kompetencave të tyre;

dh) informacioni kërkohet nga organet tatimore.

3. Të punësuarit e Autoritetit detyrohen të ruajnë konfidencialitetin në ushtrimin e detyrave të tyre.

Neni 163
Ankimimi i të siguaruarve

1. Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj krijojnë sistemin e brendshëm të trajtimit të ankesave të të siguaruarve.

2. Ankesat e të siguaruarve trajtohen në mënyrë të paanshme dhe brenda afateve të përcaktuara nga shoqëria.

3. I siguruari ka të drejtë t'i drejtohet Autoritetit nëse mbetet i pakënaqur nga trajtimi i ankesës nga shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj.

4. Autoriteti gëzon të drejtën kur çmon të nevojshme t'i kthejë për rishqyrtim shoqërisë së sigurimit ose degës së shoqërisë së huaj çështjen e ankimuar.

5. Procedura e ankimit në Autoritet përcaktohet me rregullore të tij.

KREU XI
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 164
Shkelja e dispozitave

Çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.

Sanksionet ndaj shoqërisë së sigurimit, degës së shoqërisë së huaj dhe personit përgjegjës

1. Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 1 500 000 deri në 2 000 000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë së huaj për shkeljet e mëposhtme:

a) kur shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari në kundërshtim me dispozitat e neneve 4 e 9 të këtij ligji;

b) kur shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi në kundërshtim me nenin 20 të këtij ligji;

c) kur dega e shoqërisë së huaj ushtron veprimtari sigurimi në kundërshtim me dispozitat e pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji;

ç) kur shoqëria e sigurimit vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 112 të këtij ligji;

d) kur shoqëria e sigurimit nuk respekton dispozitat e neneve 101, 102, 103, 104 e 105 të këtij ligji, si dhe rregulloret e nxjerra nga Autoriteti në zbatim të tyre;

dh) kur shoqëria e sigurimit nuk respekton dispozitat e parashikuara në nenet 107 e 108 të këtij ligji;

e) kur shoqëria e sigurimit nuk ka nivelin e kërkuar të aftësisë paguese të parashikuar në dispozitat e nenit 97 të këtij ligji;

ë) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e nenit 98 të këtij ligji;

f) kur shoqëria e sigurimit nuk ka respektuar dispozitën e pikës 1 të nenit 43, të pikës 1 të nenit 44, nenit 46, pikës 1 të nenit 51, pikës 1 të nenit 54, neneve 55, 56 dhe 58 të këtij ligji;

g) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e neneve 115, 116, 117 e 118 të këtij ligji;

gj) kur shoqëria e sigurimit nuk ka organizuar kontrollin e brendshëm dhe ka shkelur dispozitat e pikës 1 të nenit 69, si dhe të neneve 70 e 71 të këtij ligji;

h) kur shoqëria e sigurimit nuk ka raportuar në Autoritet, sipas parashikimeve të dispozitave të nenit 65 dhe pikës 1 të nenit 122 të këtij ligji;

i) kur shoqëria e sigurimit nuk ka bashkëpunuar me Autoritetin për ushtrimin e mbikëqyrjes, parashikuar në dispozitat e pikës 3 të nenit 121 të këtij ligji;

j) kur shoqëria e sigurimit nuk ka respektuar dispozitat e pikës 5 të nenit 100 të këtij ligji;

k) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e nenit 75 të këtij ligji;

l) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e nenit 95 të këtij ligji;

ll) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e nenit 111 të këtij ligji.

Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 300 000 deri në 400 000 lekë ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit për shkelje të pikës 1 të këtij neni.

Përveç sa është parashikuar në paragrafin e mësipërm, Autoriteti ka të drejtë të pezullojë personin përgjegjës nga funksioni që mban në shoqërinë e sigurimit për një periudhë njëvjeçare.

2. Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 800 000 deri në 1 000 000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit për shkeljet e mëposhtme:

a) kur shoqëria e sigurimit nuk ka raportuar tek Autoriteti, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji;

b) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e parashikuara në nenin 59 të këtij ligji;

c) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e parashikuara në pikën 3 të nenit 100 të këtij ligji;

ç) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e pikës 2 të nenit 82 të këtij ligji;

d) kur shoqëria e sigurimit nuk ka respektuar dispozitat e parashikuara në pikën 4 të nenit 84 të këtij ligji;

dh) kur shoqëria e sigurimit nuk ka respektuar dispozitat e parashikuara në pikën 6 të nenit 89 të këtij ligji;

e) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e parashikuara në nenin 109 të këtij ligji;

ë) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e parashikuara në nenet 156, 158, 159 e 160 të këtij ligji.

Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 100 000 deri në 200 000 lekë ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit për shkelje të pikës 2 të këtij neni.

Përveç sa është parashikuar në paragrafin e mësipërm, Autoriteti ka të drejtë të pezullojë personin përgjegjës nga funksioni që mban në shoqërinë e sigurimit për një periudhë njëvjeçare.

Neni 166

Sanksionet ndaj agjentëve dhe shoqërive të agjentëve

1. Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 200 000 - 300 000 lekë ndaj agjentëve dhe shoqërive të agjentëve për shkeljet e mëposhtme:

a) kur agjenti ose shoqëria e agjentëve ka shkelur dispozitat e pikës 5 të nenit 100 të këtij ligji;

b) kur agjenti ose shoqëria e agjentëve ka shkelur dispozitat e pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 77 të këtij ligji;

c) kur agjenti ka shkelur dispozitat e pikës 2 të nenit 80 të këtij ligji;

ç) kur dega e shoqërisë së huaj të agjentëve ka shkelur dispozitat e pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 87 të këtij ligji.

2. Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së agjentëve për shkelje të paragrafit të parë të këtij neni.

Neni 167

Sanksionet ndaj shoqërive të brokerimit

1. Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 800 000 deri në 1 000 000 lekë ndaj shoqërive të brokerimit për shkeljet e mëposhtme:

a) kur shoqëria e brokerimit ka shkelur dispozitat e pikës 3 të nenit 78 të këtij ligji;

b) kur shoqëria e brokerimit nuk ka respektuar dispozitat e pikës 2 të nenit 80 të këtij ligji;

c) kur shoqëria e brokerimit ka shkelur dispozitat e pikës 4 të nenit 88 dhe të pikës 2 të nenit 115 të këtij ligji;

ç) kur dega e shoqërisë së huaj të brokerimit ka shkelur dispozitat e nenit 87 të këtij ligji;

d) kur shoqëria e brokerimit ka shkelur dispozitat e neneve 156, 158 dhe 159 të këtij ligji.

2. Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së brokerimit, për shkelje të pikës 1 të këtij neni.

Neni 168

Sanksionet ndaj aktuarit të autorizuar

Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë ndaj aktuarëve të autorizuar atëherë kur këta kanë shkelur dispozitat e nenit 117 të këtij ligji.

Neni 169

Sanksionet ndaj nxjerrjes së sekretit

1. Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 100 000 deri në 150 000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë të huaj që ka shkelur dispozitat e nenit 161 të këtij ligji.

2. Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 20 000 deri në 50 000 lekë ndaj personave përgjegjës të shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë të huaj që kanë shkelur dispozitat e pikës 1 të nenit 162 të këtij ligji.

3. Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë ndaj shoqërisë së agjentëve ose shoqërive të brokerimit që kanë shkelur dispozitat e nenit 161 të këtij ligji.

4. Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 10 000 deri në 30 000 lekë ndaj agjentit, brokerit, personave përgjegjës të shoqërisë së agjentëve, shoqërisë së brokerimit dhe degës së shoqërisë të huaj që kanë shkelur dispozitat e pikës 1 të nenit 162 të këtij ligji.

Neni 170

Përsëritja e shkeljeve

Autoriteti, në rast përsëritjeje të shkeljeve, vendos dyfishimin e sanksioneve të parashikuara në nenet 165, 166, 167, 168 dhe 169 të këtij ligji dhe mund të vendosë:

- a) shkarkimin e personit përgjegjës nga funksioni që mban në shoqërinë e sigurimit, risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe në degën e shoqërisë së huaj;
- b) tërheqjen pjesore ose tërësore të licencës.

Neni 171

Njoftimi

Autoriteti njofton shoqërinë e sigurimit, risigurimit e ndërmjetësimit në sigurime e risigurime dhe degën e shoqërisë së huaj, si dhe personat përgjegjës për çdo sanksion të dhënë në përputhje me nenet 165, 166, 167, 168 dhe 169 brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit dhe kthim përgjigjeje për marrje njoftimi nga ana e tyre.

Neni 172

Arkëtimi i gjobave

1. Shumat e gjobave për sanksionet e parashikuara në nenet 165, 166, 167, 168 dhe 169 të këtij ligji derdhen në një llogari bankare të veçantë të Autoritetit brenda 20 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të parashikuar në nenin 171 të këtij ligji.

2. Autoriteti derdh në Buxhetin e Shtetit 80 për qind të shumës brenda 15 ditëve kalendarike pas datës së arkëtitimit të saj.

3. Shoqëria e sigurimit, risigurimit dhe e ndërmjetësimit në sigurime e risigurime, si dhe dega e shoqërisë së huaj, për çdo ditë vonesë nga afati i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, paguan një interes në masën 0,01 për qind të shumës së gjobës.

Neni 173

Ankimi

Shoqëria e sigurimit, risigurimit, e ndërmjetësimit në sigurime e risigurime, dega e shoqërisë së huaj dhe personi përgjegjës, ndaj të cilëve është vendosur një sanksion, ka të drejtë të bëjë ankim, në përputhje me parashikimet e dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 174

Publikimi

Autoriteti publikon brenda 5 ditëve sanksionet e marra ndaj shoqërisë së sigurimit, risigurimit, ndërmjetësimit në sigurime e risigurime dhe degës së shoqërisë të huaj, pasi kanë marrë formë të prerë, në tri gazeta me tirazh më të madh.

KREU XII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 175

1. Shoqëritë e sigurimit dhe/ose risigurimit të licencuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të ushtrojnë veprimtari në përputhje me licencën e dhënë. Shoqëria e sigurimit dhe/ose risigurimit, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, e ushtron veprimtarinë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, menjëherë pas hyrjes në fuqi të tij.

2. Shoqëria e sigurimit dhe/ose risigurimit, e licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të arrijë kufijtë e fondit të garancisë, të parashikuara në nenin 98 të këtij ligji brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 176

1. Autoriteti ka të drejtë të autorizojë një shoqëri sigurimi dhe/ose risigurimi ekzistuese, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të ushtrojë në të njëjtën kohë veprimtari sigurimi jete dhe jo-jete për sa kohë që nuk do të jetë themeluar ndonjë shoqëri e veçantë për sigurimin e jetës.

2. Shoqëria detyrohet të mbajë llogari të veçantë për sigurimin e jetës, të administrojë veças fondet e pagesat për këtë sigurim dhe të përcaktojë veças rezultatet përfundimtare. Aktivet në mbulim të provigjoneve matematike të sigurimit të jetës regjistrohen të veçanta nga aktivet e tjera dhe depozitohen në llogari të veçantë bankare.

Neni 177

Ndërmjetësit e licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë të ushtrojnë veprimtari ndërmjetësimi, në përputhje me licencën e dhënë.

Neni 178

Për subjektet që janë në proces licencimi dhe miratimi nga Autoriteti, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen të gjitha procedurat e parashikuara në dispozitat e këtij ligji.

Neni 179

Ligji nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe/ose risigurimit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 180

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 11, 77, 81, 89, 97, 98, 103 dhe 105 të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore përkatëse.

Neni 181

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4302, datë 23.8.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

* Ndryshuar me Ligjin Nr. 9338, date 16.12.2004 botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 96, viti 2004.

* * Ndryshuar me Ligjin Nr. 9685, date 26.02.2007 botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 27, viti 2007.